

Shkrimtarja dhe përkthyesja Meri Lalaj del para lexuesit me librin me kujtime "Helena, Ismaili dhe unë". Shoqe fëmijërie e Helena Gushit, bashkëshortes së ardhshme të shkrimtarit të famshëm, autorja sjell mes të tjerash ngjarje, episode të panjohura se si u dashuruan dhe u martuan Helena dhe Ismail Kadare. Për lexuesin po japim një fragment nga libri ku përshkruhet dasma e tyre.

DASMA E HELENËS DHE ISMAILIT

Nga Meri Lalaj

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani "Liria ime" i Mehmet Krajës
PËRBALLË DEBRISIT TË
KUPTIMIT NJERËZOR

Nga Ballsor Hoxha

(fq. 9)

Të lexosh Mehmet Krajën, veprën e tij, është sikur të biesh në zonën e ndërmjetme mes vetëdijes që ka kaluar në një disk që përsëritet, dhe të llumit të aeroportit të ekzistencës, ekzistencave individuale.

POEZIA E SADIK BEJKOS
SI SISTEM SEMIOTIK DHE
STRUKTUROR

Nga Alisa Velaj

(fq. 14)

Ai na shfaqet si nistor i zbulimit të vlerave të mëdha, gjë që dëshmohej në studimet dhe shkrimet e botuara që ai ia falë shkencës folklorike dhe kulturologjike shqiptare, më mirë se kushdo tjetër, si rizbulime të vlerave...

Eskadronët e vdekjes nga Bardhyl Mahmuti
ROMAN PËR FITUESIT
MORALË

Nga Salajdin Salihu

(fq. 16)

Ibrahim Kadriu, *I mbeturi në Beograd.*
Roman. *Koha*, Prishtinë 2022.

ROMAN I DRAMËS SË INDIVIDIT QË
NËNKUPTON DRAMËN E SHOQËRISË

Nga Labinot Berisha

(fq. 13)

A E KEMI HULUMTUAR
MJAFTUESHËM KOHEZIONIN E
ILOKUCIONIN E FISHTËS? RASTI I
"METAMORPHOSIS"

Prof. as. Albana Deda (Ndoja)

(fq. 6)

Ilokucioni kryesor tekstor është i mprehtë, stigmatizues, por me qëllime edukuese e me shpresë edhe shëruese. Veçse duhet thënë se shija e groteskut është e dallueshme dhe ndaj të krijon idenë e një ilokucioni...



TRE ROMANE TË NASI LERËS
QË BËJNË NJË BOTË TËRËSORE
DHE TË LARTËSUAR POETIKE

nga Anton Nikë Berisha

(fq. 10)

Romanet e Nasi Lerës "Ana Zh" (2004), "Të gjallë dhe të vdekur" (2013) dhe "Kishim një ëndërr" (2016) përlijin në mënyrë të mirëfilltë mendimin e nobelistit peruan, të sjellë në krye të këtij punimi se "[...] në thellësi të vet një shkrimtar e ndien se të shkruarit është gjëja më e mirë që i ka ndodhur apo mund t'i ndodhë ndonjëherë...



Skicë nga Bujar Kapllani

Suksese panairit
të 22^{të} të librit
PRISHTINA 2022
7 - 12 QERSHOR 2022

Në 138-vjetorin e lindjes

Shënim për Maks Brodin

nga Andrin Kabashi

(fq. 15)

AFRESKET E
KAPELËS SISTINE

Dr. Bledar Kurti

(fq. 22)



BIBLIOTEKË

Arben Dedja

The Italian Job

(fq. 17)

Agron Tufa

Borë e zezë

(fq. 19)

Andreas Dushi

Katër tatuazhe brenda

një libri me tregime

(fq. 18)

Nurie Emrullai

Kënga e re

(fq. 21)

O. Henry

Një orë plot jetë

(fq. 20)

Dhimitër Pojanaku

Një bukuri e "sëmurë"

në panairin e librit

(fq. 8)

Një lexim i romanit "Djemtë e Ballofcit"
të Zejnullah Rrahmanit

MAJAT E REBELIMIT KRIJUES
TË ZEJNULLAH RRAHMANIT

Nga Ali Aliu

(fq. 5)


Zejnullah Rrahmani bëri emër, si zë fort i veçantë në letërsinë shqipe të Kosovës, që në fillim të viteve '70. Me dy romanet e para gjatë këtij dhjetëvjetëshi, "Zanoret e humbura" dhe "Sheshi i unazës"...

DASMA E HELENËS DHE ISMAIL KADARESË

Nga Meri Lalaj

Helena dhe Ismaili do të martoheshin më 20 tetor 1963. Një javë para ditës së dasmës, ne, shoqet e saj – Sadija, Veri, Vaska, Tukja, Luixhina dhe unë – bashkuam lekët dhe i blemë një orë tavoline (të bukur për atë kohë), katërkëndëshe, me zile alarmi, të cilën Helena e vendosi përmbi televizor.

Ditën e shtunë shoqet e Helenës vajtën në Elbasan për të marrë pjesë në ceremoninë e dasmës nga ana e nuses. Unë nuk vajta. Më vinte shumë zor që t'u dilja para syve prindërve të Helenës pas asaj ndodhisë me letrën anonime; nga ana tjetër, ndihesha shumë e fyer, e inatosur dhe e mërziur, sepse sipas tyre isha unë që e pata shtyrë Helenën



Meri Lalaj, studente

në krahët e një poeti. “E ç’është ky zanat, ‘poet’?” - i pata dëgjuar njerëzit sa e sa herë që të flisnin me përbuzje për këtë gjoja profesion. E diela e dasmës së Helenës qëllloi një e diel e freskët tetori me diell. Unë dola paradite. Kisha veshur një fustan kadifeje ngjyrë okër që më rrinte pas trupit. Para disa ditësh qeshë njohur me një piktor nja dhjetë vjet më të madh se unë dhe pata lënë takimin e parë me të. Doja që ta mbushja ditën! Natyrisht që nuk më zinte vendi vend dhe nuk qëndroja dot e mbyllur në konvikt ndërsa mikja ime Helena po martohej. Pra, ndaj të ngrysur përsëri dola shëtitje me atë piktorin. Ai fluturonte nga gëzimi që do të rrinte me mua dhe erdhi për të më takuar i veshur me një xhakëtë të re stofi ngjyrë gri të errët. (Që në fillim e mora inat atë xhakëtë, sepse dukej si xhaje!) U ktheva në konvikt, ishte ora rreth shtatë e mbrëmjes. Sapo u futa në dhomë më lajmëruan se më kërkonin te porta. Dola me vrap dhe u përballa me Bertin, vëllain e Helenës. Takuam duart dhe u përqaftuam të gëzuar, pastaj duke qeshur i tregova se si më pati kaluar kjo ditë duke qenë vetëm. Berti kishte një aparat fotografik me një rrip të hollë e të gjatë që i varej te supi. Unë vazhdoja që të isha euforike dhe e pyeta Bertin se si kishin kaluar me dasmën. Ai më zgjati një copë letër, të cilën e nxori nga xhepi i xhakëtës. E kishte dërguar Helena për mua. Iu afrova shtyllës elektrike dhe e lexova: “E dashur Meri! Po të shkruaj e veshur nuse. Në Elbasan nuk erdhe. Të lutem të vish sonte këtu. Të puth, Helena.” U mrekullova. Me të

lexuar ato radhë, gjithçka e jetës sonë që nga fëmijëria e më tej më tringëlliu aty pranë me notat më të gëzueshme dhe u lumturova. Berti më shpjegoi se te shtëpia e Ismailit do të mblidheshin shokët e tij dhe shoqet e Helenës pa bashkëshortët përkatës, natyrisht në rast se do të ishin të martuar. Gjithashtu, nuk do të kishte të afërm a kushërinj. Me një fjalë, do të ishim vetëm ne, brezi i ri. Rinia që feston një martesë e që gëzohet në një dasmë.

Berti më priti te porta e konviktit vetëm pak minuta sa u bëra gati. Veshja një fustan stofi ngjyrë vishnje të ngushtë pas trupit dhe këpucë të zeza me taka të larta të holla me vidha metalike. Kisha shumë ndrojtje, sepse atje në dasmë do të takoja plot njerëz të botës letrare, të njohur dhe të panjohur më parë. Nga shoqet e Helenës erdhën Veri, Sadija, Vjollca, unë e të tjera. Shokët e Ismailit qenë shumë: Dritëro Agolli (të cilin e shihja për herë të parë), Fatos Arapi dhe Minush Jero (të cilët i kisha shokë), por ndodheshin edhe Jani Thomai, Nasho Jorgaqi, Naum Prifti (kryekrushk i kësaj dasme), Dalan Shaplo dhe shumë të tjerë. Njerëzit e shtëpisë së Ismailit kishin ikur të çlodheshin pas vizitave të zakonshme të ceremonisë martesore.

Kur u futa brenda në apartamentin e tyre, u putha me Helenën dhe ajo më tha: “Marusja, sa e gëzuar jam që erdhe!” Atë natë Helena dukej jashtëzakonisht e bukur, e gëzuar, e lumtur. Kishte veshur një fustan të bardhë taftaje pakëz të ngrirë, të gjatë deri te gjunjët, që vinte paksa i fryrë, me dy palëza te beli dhe i ngushtë në pjesën e poshtme, me mëngë

të shkurtra dhe me një dekolte të bukur katrore. Flokët në ngjyrë ndërmjet floririt dhe argjendit i kishte prerë pak përmbi supet, pjesa e sipërme pas ballukeve ishte e fryrë, ndarë në një pikë siç qe moda e atyre viteve, ndërsa pjesën e poshtme të flokëve e kishte të kthyer nga jashtë. Kishte bërë një tualet shumë të lehtë që i shkonte shumë dhe për stoli kishte vënë një byzylyk të sheshtë me copa trekëndëshe që kapeshin pas njëra-tjetrës në ngjyrë bojë qielli, po e tillë ishte edhe varësja e qafës, ndërsa një kurore e vogël qe mbështetur përmbi flokët e saj. Këpucët e bardha i kishte me taka të gjera jo shumë të larta.


Ismaili, kur shkuam ne, e kishte hequr kostumin e dhëndërisë, kravatën dhe natyrisht, edhe këpucët solemne dhe kishte mbathur një palë pantallona të rrudhosura, të rëndomta, që mbahen në shtëpi, një palë këpucë pothuaj gjysmë me qafa, të cilave edhe lidhëset nuk ua pati shtrënguar plotësisht, si edhe një bluzë diçka si pulovër. Dhe gjatë gjithë kohës kërcente. Nuk më kujtohet nëse kërcenim me muzikë magnetofoni apo ndonjë gjë tjetër. Dhomat e apartamentit qenë të hapura tejteje dhe nëpër tryezat e ngushta të vendosura anash mureve ndodheshin të shtruara pjatat me meze: kaçkavall, sallam, vezë e të tjera, si edhe gotat e shishet me pije: verë, raki, konjak. Ismaili kërcente me një vajzë, të cilën unë nuk e njihja. Ajo ishte me flokë ngjyrëgështenj të ndarë në mes, as të gjatë as të shkurtër dhe mbante veshur një fustan si në ngjyrë kafe të errët me lule të vogla nëpër të, fustani qe i hapur në gjoks me një dekolte të rrumbullakët dhe i dukeshin gjinjët.

Në një çast Fatos Arapi dhe Minush Jero më shkëputën nga të tjerët dhe atje në qoshe të dhomës, te cepi i një tryeze, duke mbajtur në duar kupat e qelqta tringëllitëse mbushur me konjak, ngritëm një shëndet për çiftin që po martohej. Fatosi tha pikërisht këto fjalë: "Më së fundi, u martuan edhe këta të dy, se na e plasën prapanicën!" E unë i thashë: "Vetëm mos harro se po martohet gjeniu me bukurinë!"

Ngado që të rrotullohej, Helena rrëzëllente porsit flutur e bardhë, e gëzuar, lozonjare, që na cikte lehtas në të tjerëve me lumturinë e vet.

Dritëroi nuk lëvizte fare nga tryeza. Ai nuk kërcente dhe vetëm pinte raki. Dritëroi qe i brengosur, sepse i pati ikur Nina (gruaja e tij ruse) së bashku me djalë, Arianin. Vetëm se ajo natë e dasmës së Helenës dhe Ismailit qëllon shumë fatlume për të, sepse aty ai pa për herë të dytë Sadijen, me të cilën u njohën, u dashuruan dhe u martuan. Mua më dukej sikur Dritëroi atë natë nuk shikonte asgjë përveç kupës dhe shokëve që i kishte përkrah, se ai kurrë nuk i ngriti sytë që të na shikonte me vëmendje dhe më kujtohet vetëm fytyra e tij e përskuqur me flokët që i binin përmbi ballë.

Mbaj mend se atë natë unë kërcëva me disa burra shumë të moshuar; kështu kërcëva me Fatmir Gjatën, tregimet e të cilit i pata lexuar që kur isha dhjetë vjeçe. Ndërsa po kërcenim



të dy, ai më tregoi se në datën pesë dhjetor do të përfundonte së shkruari romanin e tij *Armiqtë*, i cili ndërkohë botohej pjesë-pjesë te revista *Nëntori*. Të them të vërtetën, mua më çuditi shumë kjo data fikse dhe e pyeta se si ishte e mundur që ai dinte saktësisht se kur do ta përfundonte së shkruari librin e tij. "E di, - m'u përgjigj shumë i sigurt, - sepse më kanë mbetur vetëm

pesëdhjetë faqe për të shkruar e kështu e kam llogaritur".

Kur po kërcëva me Llazar Siliqin, ai më tha: "Unë kam pesë fëmijë e njëri djalë e ka emrin Risto." (E dija që e kishte pagëzuar sipas emrit të babait të vet.) Duke kërcyer me Baki Kongolin folëm për muzikë dhe kompozimet e tij. Në atë kohë ai qe me funksione në Lidhjen e Shkrimtarëve, më duket se mbante



Vetëm se ajo natë e dasmës së Helenës dhe Ismailit qëllon shumë fatlume për të, sepse aty ai pa për herë të dytë Sadijen, me të cilën u njohën, u dashuruan dhe u martuan.

postin e sekretarit për artin muzikor dhe as që mund ta parashikonim apo të na shkonte në mendje se vetëm pas disa vitesh do të katandisej keq e mos më keq; ia ndaluan veprën dhe e futën në burg.

Fatos Arapi më tha që të kërcëja me Andon Kuqalin, pasi ai dinte vallëzimet e fundit moderne, por Fatosi sigurisht që donte të bënte shaka, sepse Andoni as pinte dhe as nuk dinte fare të kërcente, vetëm rrinte në një kolltuk duke vështruar ata që argëtoheshin.

Pas mesnatës, Dritëroi dhe të tjerët që kishin pirë filluan të lëshojnë fishkëllima të mprehta duke futur gishtërinjtë në gojë. Ndoshta ishte ora dy e mëngjesit, kur në derë trokitën dy policë. Nga ana jonë dikush iu afrua atyre dhe u kërkoi falje për zhurmën e pasmesnatës. Ata, me sa duket, u kënaqën që u gjendën midis poetëve. Kështu, pasi pinë nga një gotë raki, i uruan jetë të lumtur çiftit, nderuan ushtarakisht dhe u larguan. Aty pas orës tre të mëngjesit u larguam edhe ne të tjerët. Nuk kishte autobusë dhe e vazhduam rrugën më këmbë. Unë i hoqa këpucët dhe çorapet dhe eca zbathur deri në konvikt. Nëpër rrugë mbretëronte heshtja dhe qetësia. Asgjë nuk pipëtinte. Njerëzit e Tiranës flinin gjumin e ëmbël të orëve të para të ditës së re. Ata nuk e dinin se ishin martuar Helena dhe Ismaili.

XXX

Njëherë, ne studentët na patën radhitur në mes të Tiranës, në afërsi të Rrugës së Elbasanit, për të përshëndetur delegatët, të cilët po hynin në sallën e Kongresit të Tretë të Partisë. Ishte mëngjes. Pastaj u larguam si të mpirë. As që ia kishim idenë se çfarë bënin ata burra nëpër kongrese!

Pasi qemë prishur me të gjitha demokracitë, vendi ynë po afrohej politikisht me Kinën Popullore. Dhe ngjarjet u rrokullisën. Kështu, më 31 dhjetor të atij viti kur u martua çifti Kadare (ndërsa duhej të përgatiteshim për festën e Vitit të Ri), ne studentët dhe popullin e Tiranës na rreshtuan nëpër anësoret e rrugëve për të pritur me përshëndetje dhe duartrokitje mirëseardhjeje Çu En Lain e Kinës Popullore. U mërzitëm aty duke ndenjmur kot më kot mbi dy a tri orë vetëm për të pritur minutën kur ai do të kalonte me makinë për në Pallatin e Brigadave. Çu En Lai bashkë me delegacionin qëndroi për disa ditë në Shqipëri. Kështu, kur iku, ne patëm filluar sërish mësimet pas provimeve. E përsëri e përcollëm, kësaj here na grumbulluan para sheshit kryesor të Universitetit. Aty u mbajt një miting. Ndodhi që në një çast unë u gjenda veç një pëllëmbë larg Çu En Lait dhe atë e rrethoi luzma e gazetarëve kinezë me aparatet fotografike. Papritmas, sikur mbiu nga toka, një gazetar biond amerikan, vigan me trup (kinezët arrinin deri te beli i tij). Ai, me disa lëvizje, që na la ne gocave pa mend në kokë, po filmonte me kamerë

(Vijon në faqen 4)

(Vijon nga faqja 3)

televizive. As që na hynte më në punë Çu En Lai, e gjithë vëmendja jonë qe e përqendruar te gazetari. Nuk kishim parë kurrë amerikan me sy.

Paskëtaj, në muajin shkurt, ne bëmë praktikën mësimore në shkollën *Petro Nini Luarasi*, në të cilën ndiqnin mësimet të gjithë fëmijët e pushtetmbajtësve. Një ditë Sula (Sulejman Mato) po shoqëronte njëerën nga vajzat (na pati thënë që më përpara se asaj do t'i propozonte për dashuri). Ne ecnim prapa tij për të dëgjuar se si do t'i sajonte ato fjalët e propozimit dashuror, kur ç'të dëgjojmë: "Ama edhe Hrushovi, që ishte mik i Shqipërisë, na e dhjeu fare!" I gjori Sulë, po i jepte propozimit ngjyrim politik!

Unë vazhdoja leksione, provime, sërish leksione. Një ditë në fillim pranvere erdhi në dhomën time në konvikt Helena. Tani dhomën e kisha paralel me Ambasadën Italiane (Ambasada Amerikane në ditët tona). Helena kishte veshur një fund të trashë stofi në ngjyrë të errët me cirka dhe një triko në ngjyrë rozë të çelur.

- Si po ia kalon me Ismailin? - e pyeta.

- Mirë fare, - m'u përgjigj. - Do të të tregoj një sekret, tani për tani mos ia thuaj asnjëri... Kam ngelur me barrë, - tha ajo.

Provova një ndjenjë të çuditshme: gëzimi, hutimi, habie. Dësh ia këputa që të lëshoja atë shprehjen tonë aq të pëlqyer: "Tjetër prift, të tjera kartëra!", por e kuptova se çasti qe tepër serioz. Helena tani po bëhej me fëmijë, po hynte në një tjetër botë më të vërtetë (larg çapkëllëqeve!), do të lidhej më fort me Ismailin dhe me familjen.

- Po Ismaili çfarë thotë për bebin? - e pyeta.

- E do. Ka qejf të bëhet baba, - u përgjigj Helena.

Në verë, pasi mbarova studimet, vajta te Helena për dy ditë, pastaj në Durrës. Helena dhe Ismaili tani banonin te pallatet e sapondërtuara në Pazarin e Ri, ku në katet e poshtme ndodheshin shitoret e valutës (në të cilat njerëzit, natyrisht ata që kishin monedha të huaja, blinin mallra).

Kur isha njëherë në apartamentin e tyre, Gresa qe nja pesë- a gjashtëmuajshe. Dhoma ishte rrëmujë me plaçkat e bebit, por Gresa ishte foshnjë e qetë, rrinte shtrirë në divan pa bërë zë dhe pa pasur njeri pranë, pa qarë fare. Ismaili iu afrua, i jepte gishtërinjtë, ia kërciste lehtë, i fliste me fjalë të rrokëzuara për t'i tërhequr vëmendjen. Ismaili mbante në dorën tjetër një bllok të vogël shënimesh dhe një laps, diçka ishte duke shkruar.

Njëherë vajta te Helena me vajzën time të vogël, Manjola, që në atë kohë ishte vetëm një vit e gjysmë. Manjola bënte shumë zhurmë, tërhiqte një karrige të përmbysur e lëshonte britma. Ismaili erdhi nga dhoma e vet e punës duke thënë: "Kujtova se çfarë po ndodhte me gjithë këtë zhurmë!" Dhe me Helenën përsëri përmendëm se sa fëmijë i qetë dhe i heshtur pati qenë Gresa e vogël.

Në apartamentin e Is në Tiranë dasma jonë mori tjetër karakter. Për ta bërë këtë dasmë, në vrull e sipër Is vajti dhe shiti aparat kinematografik që kishte sjellë nga Moska, bashkë me laboratorin e montazhit dhe të larjes së filmave. Kishte vënë re se ajo punë i merrte shumë kohë të çmuar dhe, veç kësaj, pas disa xhirimeve, i kishte ikur edhe pasioni që kishte pasur në filmim.

Bashkë me pak njerëz të fisit dhe me shokët e vet, Is kishte ftuar në dasmë pothuaj gjithë shkrimtarët e Tiranës. Si rrjedhojë e polemikës së gjatë e tepër të ashpër në shtyp midis të rinjve e të vjetërve, një pjesë e madhe ishin ende të zemëruar keq me njëri-tjetrin e nuk flisnin me gojë. Në tryezat e shtruara në të gjitha dhomat dhe në korridor kishin zënë vend sipas klaneve letrare, nën shikimet kureshtarë të familjarëve. Të gjithë prisnin se çdo të ndodhte mes tyre, por Is nuk ndihej fare i shqetësuar. Dukej sikur ky tension e zbaviste.

Më tepër se nga pija, atmosfera u shkri krejtësisht kur erdhën shoqet e mia studente nga konvikti i vajzave kryesisht. Shkrimtarët i harruan mllfet dhe u sulën të vallëzoinin me to.

Dasma vazhdoi kështu e gëzueshme gjer ndaj të gdhirë. Ndo-dhnin ca si incidente të vogla, por fatmirësisht ato harroheshin aty për aty.

Ndërsa po kërceja, më zunë sytë në një nga tryezat shokun tim të kursit, Minush Jeron, autorin e dramës *Njollat e murrme*, që do ta çonte atë pas ca kohësh në burg. Atë çast, ai po grindej me poetin militant Luan Qafëzezi. Nën mosvëmendjen e përgjithshme, ata e kishin kapur njëri-tjetrin për fyti dhe ndërsa Minushi i thoshte "Mëgjithëse emrin e ke Luan, në letërsi nuk je veçse një keq", Luani i përgjigjej: "Kopuk liberal, gjynah që s'e kam koburen, pa do ta shihje!".

Në një rast tjetër kjo gjë do të më tmerronte, por ngaqë isha si në re ia plasa të qeshurit dhe po kërkoja me sy Is, për t'i treguar se ç'po ndodhte.

Në të vërtetë kishin ndodhur plot gjëra të tjera gjatë dasmës. Një nga ngjarjet ishte njohja dhe afrimi midis shoqes sime të kursit, Sadije Kecit dhe Dritëro Agollit, që do të bëhej më vonë burri i saj.

Aty nga ora pesë e mëngjesit njerëzit nisën të largoheshin. Një pjesë zbrisnin shkallët dhe ktheheshin prapë, i binin derës dhe kërkonin të thoshin edhe ndonjë mendim që iu kishte mbetur pa thënë. Më në fund, mezi ikën dhe ne mbetëm vetëm, të lumtur dhe të dëshiruar për njëri-tjetrin.



DITA E DASMËS SIPAS LIBRIT ME KUJTIME TË HELENA KADARESË

HELENA KADARE

Kohë e pamjaftueshme

KUJTIME



Onufri



Panairët e librit do hapeshin nga vjeshta e dytë. Lufta, një luftë e ftohtë, plot dredha, kish kohë që kish filluar. Pasioni tek shkruarit pa talent të dukshëm, punonte ethshëm, pa orar. Mediat e shkruara dhe vizive ishin pothuaj në këmbët e tij. Me një bukurshkrim magjeps kish cituar nëpër banderola vargje të poetëve të tij më të spikatur, bezet ishin lidhur fjongo në trupat e neonëve. Në Mongoli, panairi ish hapur më shpejt se në vendet e Evropës. Ndodhitë e dy ditëve të para, lindën nevojën urgjente të një takimi mes pasionit tek shkruarit me talentet të dukshëm dhe të pasionit tek shkruarit pa talent të dukshëm. Takimi nxitej nga botuesit e pasionit të poetëve me talent të dukshëm. Botuesit, kishin zbuluar ndër disa syresh, shenja gjenialiteti dhe trembeshin se mos kjo shpërfille qaq e hapur, mund t' i lëkundë ndjeshëm poetët e brishtë.

Para se të hapej panairi, lexuesit ngriheshin që në orët e pasmesnatës, zinin rradhë. Stendat e poetëve pa talent të dukshëm i kish mbërthyer paniku. Librat shiteshin rrufe, shtypshkronjat punon nën një trysni të paparë. Dy poetët pa talent të dukshëm, që pasioni i kish vënë moderatorë në disa stacione televizive të njohura, mend po mbyteshin nga njerëzia. Rradhët e gjata drejt tyre i ngjanin peligrinazheve të Mekës. Rrëmuja, përplasja, kish sjellë edhe të lënduar ndaj, para rrugës të panairëve, ambulancat rrinin me sinjale ndezur e shpesh vërshëllimat e tyre të rrëqethnin.

Pasioni te shkruarit pa talent të dukshëm, kapardisej, ngrefosej, nuk donte të ulej për bisedime. Erdhën emisarë nga vende të njohura, akademikë, diplomatë, fitues të nobelit në zgjidhjen e konflikteve më të nxehta, por pasioni nuk donte të dëgjonte nga ai vesh. Thonë se e bindi një emisar nga Tunizia. Ai ju përgjërua se donte një vend tek pallatet e tij, qoftë edhe në katet përdhes, se enkas kish veshur petkun e emisarit. Pasioni u josh, lëshoi pe. Bisedimet u zhvilluan jashtë kamerave, diku nën brinjë të Alpeve. U arrit që të paktën një rresht i lexuesve të zinte rradhë para stendave ku shfaqeshin librat e pasionit tek krijuesit me talent të dukshëm. Kështu ndodhi, por rradhja drejt poetëve me talent të dukshëm, ishte tepër zbehtë, e heshtur, e qetë si agoni. Ndoshta, botuesit, të cilët e prisnin një shpërfille shokuese të paparë e dëgjuar prej vitesh, sajuan të tjera rrugë për poetët me talent. Dikush mungonte se kish takim tek mbreti i Persisë, dikush tek një konference paqeje. Nëse ata nuhasnin marëveshjen, do u thyhej krenaria që u buronte nga vetëdija e krijimit dhe do ndërprisnin kontratat e botimit. Pa dale, se më duket po gaboj. Më ra në sy një poet serb, kandidat dy herë për çmimin mbretëror të Spanjës. E njoha nga koopertina e pasme. Rrinte i mardhur, si një zogth i vogëlth i rënë nga foleja pikërisht në dimër, në atë dimër të egër për të e për të gjithë sojin e tij, ndërkohë që tek poetët pa talent të dukshëm pranvera, derdhte pa kursim hiret e saj.

Por ja ndodhi ajo që ish paralajmëruar, që nuk kish shmangie,

NJË BUKURI E "SËMURË" NË PANAIRIN E LIBRIT

nga *Dhimitër Pojanaku*

që dogji atypëraty pikën e vetme të marrëveshjes së arritur në brinjë të Alpeve. Posa u derdh lajmi se po vinte për autografe njëri prej autorëve të librit të një poeti pa talent të dukshëm, rradhët u shprishën, turma rendi drejt poetëve, filluan brohoritjet, klithma gëzimesh, hipnin mbi supet njeri tjetrit, dhe kur mbërrinin për autograf, mezi merrnin frymë, pikonin mbi bojë dhe kthenin siglat e mbishkrimeve në hieroglifë të padeshifrueshme.

Në të njëjtat ditë, në Paris ndodhi një incident që ja plasarit paska famën pasionit pa talent të dukshëm. Në stendën më të populluar, qëndronte si sfinks, një poet me profesion psikiatër, afër moshës së tretë, që botonte për herë të parë. Pasioni vetëm tani mundi ta kapte. I kish rënë pas edhe në rininë e hershme, por xixa nuk ju ndez. Xixa kish ndenjur e fjetur por aspak e shuar. Ethet e pragpleqërisë e zgjuan tmershëm. Për më pak se një muaj, poeti krijoi njëqind lirika, të gjitha për dashurinë. Botuesi do i printonte në pesëdhjetë mijë kopje. Zjarrmia e krijimit e kish kthyer poetin në trillet e adoloshencës. Posterat e poetit llamburitnin panairin. Lindja e këtij poeti në moshë të thyer, ish një nga

kryeveprat e pasionit tek shkruarit pa talent të dukshëm. Kish ndodhur edhe herë të tjera por fuqia e krijimit nuk kish zbritur kurrë-më-parë me qaq revan. Konferencat e panumurta për shtyp para panairit, e kishin kthyer poetin në mit. Më duket se u largova pak nga incidenti, por dekorova pak skenën për të kuptuar përse fakti mori përmasa tronditëse. Pra, nga turma e panairit, ju afrua poetit një vajzë e bukur, me trupin lastar, me flokë të zinj e të shndritshëm si nata në hënë të plotë, me sy përpirës. Sy të kaltër me thellësira blu.

Ish modele. Modelja, në vend t' i jepte librin për autograf siç e donte nderi, i zgjati poetit famoz një kartelë mjekësore. Kërkonte me ngulm t' i shënontë një ilaç të ri kundër depresionit që ja kish këshilluar një plakë mulate. Ma hiq zoloftin, doktor, i përgjërtoj. Kam makthe në pasarelë, nuk buzeqesh dot! E di që një modele pa buzëqeshja është ai ajo diva e skenës kur zërin ja zë shtriga në mes të këngës?! Katër idhtarë të poetit, renditur si në një konkurs badybuilding, i grisën kartelën. Qaq mjaftoi që modelen ta mbërthte një krizë e fuqishme histerie, të bërtiturat saj drodhën ndërtesat e larta qeveritare

që ishin përballë salloneve të panairit.

Modelen e ngritën hopthi, duar më duar, se poshtë nuk kish rrugë, e nxorrën tek ambulancat, që edhe këtu, ashtu si Mongoli, ishin sërënditur si taksitë pritëse. Ma hiq zoloftin, doktor, çirrej ajo. Ma kthe buzëqeshjen! Në ikje ju shuan edhe rrokjet e fundit plot ngashërime. Të gjithë i çuditi qetësia e poetit psikiatër. M' u kujtua, bëlbëzonte poeti me një të qeshur narcisti, nga to që nuk ju drejtohej askujt, por qiejve. M' u kujtua, përsëritte, vinte që e vogël tek unë. Është e sëmure mendërisht, shumë e sëmure, por, fatkeqsisht, jetojnë edhe bukuri të sëmura.

Mimo nobelisti që jetonte afër korpuseve të gradiçelave te pasionit të shkruarit pa talent të dukshëm, nuk ish në dijeni të panierëve. Tek zbriste nga papafingo, streha e tij e krijimit, në televizorin ku po shihte Tesa, pa skenën e modeles. Po kthehen, përsëpëriti, më shumë si për vehten. Cilët?, reagoi Tesa. Ata. Cilët Ata? Tanët. Tesa desh ta pyeste më tej por ai kish ngjitur tok me gotën e qumështit edhe shkallën e fundit. Po kthehen. Ata. Tanët, meditoi Tesa. Po cilët po kthehen? Kuptohet, të ikurit. Po si ktheheshin, të humbur apo fitimtarë. Dhe për kë ktheheshin, për kë?! Eh, moj Tesa, i foli vehtes për herë të parë me zë të lartë. Nuk u mësove me nëntekstet e tij? Në letra, ai kur do edhe ujin e fsheh nën rrogos. Pse hyn në një pyll kur e di se nuk del dot. Jo, nuk duhet të dorëzohem, këmbëngulte Tesa. Doemos, duhet t' i kthehem ekranit, ta rrishoh skenën. Atje rri zgjidhja e enigmës.

Pasioni pinte në një kazino kur i sollën lajmin. Mend u xhingos. Dyshoi se mos vajzën, e kish infiltruar pasioni tek shkruarit me talentet e dukshëm për të mbjellë gjullurdi. E përse u dashka erdhur nga Ukrainë në Paris për ca flakonë depresivë?! U shojtën mjekë psikiatër? Gënjeshtër me bisht! U bë mavi në fytyrë, iku në dhomë, dhe morri një vendim, ndoshta një vendim që do ish fatal për pasion me talent të dukshëm, të cilit i kish shërbyer deri ahëre me devotshmëri të përkorë. Hëpërhë, që të mos nxitohej, vendosi që para vendimit përfundimtar të linte një takim tetë a tetë, në dhomën ku fumoheshin zërat, me poetin psikiatër. Duhej dëgjuar version i tij. Ndërkohë, nëpër korridoret e pallateve te qelqta, shëtiste si fantazmë një gojëthënë, që nëse do diltë e vertetë, do sillte një tjetër rrënim për pasionin. Përflitej se kandidati për nobel në stenden e panairit nuk ishte poeti i vërtetë por sozia e tij. Poeti i vërtetë ndodhej për kënaqësinë e një mikeshe, në ceremoninë gala të çmimeve Oskar. Nëse kjo konfirmoj, ishin të gjithë të sigurtë se pasioni tek talentet e padukshëm, mund të kish fatin e modeles ukrainase.

Pasioni priste në ankth. Po shkonte dy pas mesnate dhe doktori s'po dukej. Në stendat librore, rradhët e lexuesve tek poetët pa talent të dukshëm s' kishin asnjë shënjë zbeheje. Ndërkohë, të gjitha kanalet televizive ndërprejnë programet duke titruar lajmin më të fundit. Vëllimi poetik "Më veremosi dashuria", i poetit psikiatër, sa hap e mbyll sytë, ish kthyer në best seller.

Lajmi po rrotullohej botës.

(nga proza "Dredhitë e pasionit")



Të lexosh Mehmet Krajën, veprën e tij, është sikur të biesh në zonën e ndërmjetme mes vetëdijes që ka kaluar në një disk që përsëritet, dhe të llumit të aeroportit të ekzistencës, ekzistencave individuale.

Në të vërtetë është sikur të gjendesh, apo thënë më saktë të jesh i mbetur nën marrëveshjet: kohë, lumturi, logjikë etj. dhe prej këtu bota ngjanë në një gogël e cila mu sikur një botë e pabalancë, apo të humbur balancën, nuk ka madhësi, por është perspektivë nga kjo ndërmjetësi.

Kraja si autor qysh në fillim të rrëfimeve të tij e shpartallon çfarëdo logjike të marrëveshjeve të lartcekura, dhe në këtë çdo gjë, prej grimcave kancerogjene në trupin e një nga personazheve, e deri tek një qen i humbur që vetëvritet po ashtu në aeroport, subjektivizohen brenda narrativit. Kjo mundëson që narrativi të kalojë në një situatë të manipulueshme bashkë me personazhet të cilat shthurur marrëveshjet e kuptimit dhe të strukturave të lumturisë të qëniesojnë diku ndërmjet skizofrenisë dhe të një zhgënjimi aq të thellë që rrënon çdo mundësi shprese.

Këto personazhe, për çudinë e lexuesit janë të pajtuar në masë të madhe me fatin e tyre, me zhgënjimin e tyre kozmik dhe real dhe kanë një të përbashkët e që është shtjellimi i pyetjeve dhe gjakimeve krejtësisht të largëta e të pambizotërueshme. Në të vërtetë janë aq të vetmuar në këto strata ku zhvillohen këto situata sa që pyetjet e tyre e bartin dhembjen nga rrafshi i vetëdijes, rutinës dhe njerëzores, në kozmike të pashkatërrueshme dhe të paarritshme.

Stratat ku ftillojnë dhe shtjellohen situatat me karakter unik Krajan, janë disa herë aeroporti i Prishtinës, mërgimi dhe edhe, në një rast edhe në emergjencën e spitalit. Të shumtën e herave personazhi në vëmendje është i 'padukshëm' për të gjithë njerëzit përreth, janë më shumë bartës apo thënë më saktë rezonanca e kolektiveve ku po këto personazhe qëniesojnë. Qëniesimi i tyre është i paatashim dhe i pa reagim, sikur çdo gjë çon drejt nihilizmit të këtyre forcave të cilat shpartallojnë çdo njerëzore, dhe aq më shumë të njëjtën njerëzore e nxjerrin si marrëveshje të kolektiveve.

Të prirë për të gjetur një shkak dhe një pasojë, një fat, njeriu në këtë roman e ka të përmbysur çdo gjë që ka lidhje dhe koncepti fati të njeriut, dhe e tëra është një vdekje e ngadaltë dhe e vërtetë, apo thënë më saktë një jetë kaluar murin ndarës të vdekjes dhe jetës, në një vetmi të papërcaktueshme dhe të pakapshme në pamundësinë e qëniesimit të tyre. Në një perspektivë autori, apo narratori, janë aq mizorë sa që sajojnë situatat kur më në fund duket sikur drejtësia, qoftë ajo poetike, do të ngadhënjë mbi të ligën, ato përmbysen dhe fiton gjithësi e liga. Kështu duke e trajtuar ekzistencën si të ftohtë, të pandjeshme dhe të pakapshme ndonjëherë në mundësitë tona.

Ekzistenca e njeriut dhe liria

Kjo sigurisht kujton Schopenhauer-in dhe filozofinë e tij rreth ligësisë së tokës dhe stërkeqjes së saj derisa njeriu e sheh atë si diçka pozitive dhe progresive. Dhe më tutje shtron dilemën nëse kjo vepër ka të bëjë me ekzistencializmin nihilist apo me lirinë, kjo e fundit si e përcaktueshme. Por në këtë vepër të gjithë personazhet janë të lirë, janë të deponuar jashtë marrëveshjeve dhe strukturave ku ndërtohen parimet tona mbi po të njëjtat marrëveshje, dhe me këtë janë të lirë, të lirë deri në ekzistencialen e qenies, gjë që do të thotë se janë të lirë prej çdo superegoje dhe egoizmi të tyre, janë, siç u tha më lartë të pajtuar me të qenit dalë jashtë trajektoreve të njerëzores me fat, me lumturi, me vetëdije etj.

Ekzistencialja dhe liria janë krejtësisht të ndryshme brenda koncepteve ekzistencialiste, në to liria është robëria më e madhe e njeriut ndaj të gjitha shtyllave

Romani "Liria ime" i Mehmet Krajës

PËRBALLË DEBRISIT TË KUPTIMIT NJERËZOR

Nga *Ballsor Hoxha*

primordiale dhe nuk kanë të dalë jashtë tyre. Në të vërtetë, në konceptet ekzistencialiste liria është ekspozimi më i thellë dhe më i saktë i robërisë së njeriut ndaj universaleve dhe primordialeve të saj.


Po e njëjta është edhe në veprën e Mehmet Krajës "Liria ime", mirëpo këtu kjo liri është e motivuar edhe me të ligën e njeriut ndaj njeriut. Ky motiv në të vërtetë e bën veprën edhe eksplorim në personalen e njeriut, në pandashmërinë e tij nga vetë shpikjet/marrëveshjet e tij dhe ekzistenciales. Bymehjen dhe tkurrjen e këtyre shpikjeve/marrëveshjeve të njeriut me njeriun brenda i cili si një peng nuk di ku apo si të dalë jashtë tyre.

Jo pa arsye, e shumta e personazheve janë apo përfundojnë në përafri të debrisit të botës, duke e kundruar apo edhe duke e pyetur veten, e qoftë edhe një personazh të dytë, gjë që në shumë raste është vetë narratori, për gjërat në amshim të ekzistencës. Këto personazhe janë saktësisht të shpartalluar, të zgjidhur çfarëdo atashimi me këtë botë, gjë që e bën

lirinë e tyre më të zhveshur se kurdoherë tek njeriu, gjë që e bën të mundshme që të kundrohesh çdo grimcë e materies apo anti materies, sipas po këtyre personazheve.

"Liria ime" është një shpallje, e lirisë së autorit, gjithnjë duke menduar në pandashmërinë e rrjedhës së trajektoreve së njeriut nga tjetri në këtë botë, mirëpo ka edhe së paku një pikëpamje mbi këtë titull e që është vetë klithja e njeriut me absurdin e lirisë, me absurdin e të qenit i zgjidhur dhe detashuar nga kuptimi i botës së tij/saj.

Prej këtu ndodhemi të hedhur (Heidegger) në pandjeshmërinë e kësaj toke ndaj njeriut, dimë të jetojmë vetëm me peshën e të qenit i izoluar brenda këtyre atashimeve siç janë vetëdija, logjika, etj. Gjë që do të thotë se liria jonë nga cilido rrafsh që shihet është dhembje. Dhembje e pamundësisë së të kuptuarit të vetë saj. Në të vërtetë ka shumë ngjashmëri, ky roman me momentin pas deklarimit të Dostojevskit "çka nëse nuk do të kishte zot?" "Atëherë çdo gjë do të ishte e lejuar!", është më se e qartë se ky titull, kjo klithje është



pikërisht klithje e njeriut se "çdo gjë është lejuar", e deri tek pajtimi me po këtë lejim të çdo gjëje në këtë botë tonën.

Kjo është paradoksi i ekzistenciales, përballë lirisë, apo ndërthurjes së ekzistenciales me lirinë, sa më e thellë, sa më e zhveshur njëra, aq më e dhembshme tjetra. Gjë që na kthen tek personazhet e Mehmet Krajës, horizonti i pamjeve të tyre, pikëshikimeve të tyre, të meditimit të tyre, qoftë mbi të ligën që i ka goditur e tronditur në përhershmëri, e qoftë mbi pajtimin e tyre me po të njëjtën ligësi, apo qoftë ta quajmë fund të marrëveshjes botë.

Tregimet brenda romanit "Liria ime"

Romani fillon në aeroport, dhe përfundon, po ashtu në aeroport, gjë që na kthen pikërisht në mbledhinë e njerëzve ardhur dhe nisur në të gjitha kahjet e botës, në mbledhinë e të gjitha halleve të botës, kështu duke e zbritur kuadrin e narrativit deri në grimcat kanecrogjene në personazhin e tregimit të parë, e deri tek një qenë i braktisur që bën vetëvrasje pikërisht në aeroport.

Personazhi kryesor është gjithnjë me armikun e tij, qoftë të imagjinuar e qoftë nga përvoja e jetës së jetuar.

Siç edhe pritet narrativi braktisë aeroportin për të ateruar në vende të largëta, të humbura e të humbur përbrenda debrisit të shpartallimit të të njohurisë dhe të marrëveshjeve në këtë botë.

Por ç'i bën këto tregime, roman, siç e ka quajtur autorit këtë vepër, me qenë se nuk ka një situatë, temë apo edhe bartje të ngjarjes nga njëri kapitull në tjetrin.


Kjo është ajo që e kam quajtur në rrëfimet e mia, asonancë e bartur e jo vetëm të zhgënjimit, dhe të ngadhënjimit të debrisit të kuptimit, por është edhe ajo që këta personazhe janë të mbetur në kufirin e fundmë të ekzistencës në vrojtim të kimerës së quajtur jetë dhe megjullnajave të moskuptimit apo absurdit të kësaj që e quajmë botë.

Tregimet përmbahen në një të ulur përballë debrisit të kuptimit të këtyre marrëveshjeve dhe të vrojtuarit të pamundësisë së pamundësisë njerëzore, qoftë brenda sajimit të tij qoftë brenda asaj që vazhdimisht provojmë ta përkufizojmë brenda konceptit të strukturave si ajo e lumturisë.

Siç u tha në fillim të këtij punimi, e tëra është e rënë nën strukturat e kuptimit njerëzor, dhe gjendemi në një kontekst të simbolizuar që përmban si aurë të gjitha tregimet e kësaj vepre.

Në të vërtetë në çdo tregim gjendemi sikur përbrenda eksplozimit të njerëzores, siç është e konceptualizuar, dhe pluskojmë në mungesën e gravitacionales së njerëzores.

Por pse të jetë që këto tregime të jenë një roman, derisa çdo gjë është një situatë e ndryshme, një jetë e tërë e jetuar nga këto personazhe dhe po ashtu një fund, doemos, i këtyre personazheve që nuk përkon me asnjërin prej tyre? Ndoshta, autori e ka menduar një valë që ka përfshirë njerëzimin si një stadium ku shtresa e ndërmjetësisë, siç u tha në fillim, ndërmjet vetëdijes së njerëzores, dhe të llumit të ekzistencës në aeroportin e njerëzimit.



OnufriRoman

Me poezinë e tij më të mirë Bejko ndërton një sistem poetik nga më të ndërlikuarit, si në strukturë, si në semiotikë. Po t'i rikthehemi edhe njëherë vargut "Na ndjek i korbave krrokimi" shohim se shenjuesit tekstorë krijojnë një tablo të gjallë të një vdekjeje të dyfishtë. Ca kufoma djegaguri që vdesin tani, vdesin pastaj. Sipër tyre një re me korba të uritur që nuhasin kufoma dhe presin të ulen mbi prenë që e kanë para syve. Korbi nga zgafellja dhe reja me korba sipër. Midis vdekjes në tokë dhe vdekjes që endet nëpër ajri, ndodh ecja e karvanit tej një vdekjeje e tej një zgjimi. Një vizion halucinant i një udhëtimit mbrëmjeje plot gurë, korba dhe njerëz skelete që mezi marrin frymë. Për më tepër është dhe drita që po shuhet ngadalë, si një proces shuarje shprese. Në udhëtimet mbrëmësore, vizionet mbushen më tepër me makthe dhe përfytyrime ndjellakeqe. Vizionet halucinante ngjizen në poezinë e Bejkos bash kur rrënim shpirtëror rrëmben të gjitha hapësirat e ndijimit e të shikimit. Në një çast të tillë, jo të thënë, por të nënkuptuar poeti kërkon me sytë e përhumur trajtën vegimtare që do ta përtërinte prej themeleve këtë djerrinë vertikale. Në poezinë "Fytyrë e panjohur", e cila i jep titullin dhe vetë vëllimit të botuar në vitin 2003, ky proces i përtëritjes përshkruhet me anë të këtyre vargjeve: "Ka një grimëherë bosh kur bie dita/ E largët sa s'mund ta prekësh me dorë/ Ja, hedh rrobat, po kridhet në lumë/ me duar, sy, me ç'mbetet të fton për larg/ është e mollët, me ngjyrën e mollëve/ që bien, dhe - është një hon në flakë". Ky imazh ëndrre vegon përmes shëmbëlltyrash të ëndshme dhe të pakapshme me dorë, por që t'i çmend shqisat. Mandej përfytyrimi shkon deri aty sa poetit i shfaqet një fytyrë e dashur në tërë vertikalisht tokë-qiell. Citojmë vargjet: "Fytyrë e panjohur gjer në qiell/ Buzagaz... tufë flokësh që në çast/ era i thërmon me qerpikë drite/ Mendtë të merren, rrëzuar mur/ e themele: në të ra të fikët, është pak/ në honin këtu e gjer në qiell me flakë". Nga vargjet dalin qartë shenjuesit e honit këtu dhe qiellit me flakë. Kur honi/honet tona apo themelet tona reale mbushen me këtë fytyrë të panjohur, që merr trajtën e një pranie dëshirimi, ne përpohemi në flakët qiellore si genie të përtëritura me flatra drite. Një vegim apo halucinacion të tillë, plot hone tokësore e shpirtërore paraqet edhe poezia "Shtyllë dheu", për të cilën Bejko pohon: "E shihja këtë shtyllë dheu siç e kam shkruar. Ndoshta nga ankthi i një Shqipërie, një atdheu, i një shteti-komb, që mbetet ende si një trup, torzo, trung i papërfunduar, i copëtuar".

Në fjalët e poetit vërtetojmë gjithë atë çka vjen në magjen e një poezie si gjendje e pavetëdijshme, si ankth apo makth i yshtur nga referentë konkretë socialë e shoqërorë, ndërkohë që lënda qiellore në poezinë e Bejkos vjen si vizion halucinant kur prek përmasën vizionare të poezisë dhe shfaqet si vizion a vegim i pastër (aspak halucinant) kur ndërgegjja mitike ngjiz deri dhe strukturat e medimit poetik. Ky ndikim i fundit është i thekshëm në shijet e frazave poetike që vijnë në formën e një leksiku mitik, në sintaksën dhe morfologjinë e secilit varg. Për të vërtetuar praninë e ndërgegjes mitike le t'i referohemi poezisë "Psalm Gjon Buzukut" nga vëllimi "Psalm për atin" dhe t'i rikthehemi edhe njëherë poezisë "Unë po ju them" nga vëllimi "Si vdes gruri". "Psalm Gjon Buzukut" është dukshëm një poezi patriotike. Në spiralen e tragjedive tona, edhe ne kemi faje të rënda, pasi nuk kemi qenë dhe nuk jemi ende në lartësinë e misionit tonë. Teksti poetik ngrihet mbi paratekste. Një prej tyre është pasthënia

POEZIA E SADIK BEJKOS SI SISTEM SEMIOTIK DHE STRUKTUROR

Nga Alisa Velaj

e "Mesharit" të Gjon Buzukut, me termat *gluha, e në dashunës botës sane dhe të vemi më shumë në klishë*.

Vargjet "Pëllumbi em në plasë të gurit e ndë e fshahunat e gjirdheve...eja se dimri shkoi dhe shiu vote" janë cituar nga "Kënga e këngëve", sipas variantit përkthimor të Buzukut të "Meshari". Lënda biblike rrimet në rrafsh diakronik, për të aktualizuar mesazhe të rrafshit diakronik e sinkronik gjithashtu, si edhe për t'i dhënë tragjedive tona një përmasë universale. Në fund të fundit, në çdo komb dhe në çdo atdhe rrënim shpirtëror i individit është i pashmangshëm kur realizimet e idealet e mëdha mbeten në duar misionarësh që janë të tillë vetëm *de jure*. Rrafshi diakronik me referentë biblikë, të cilët nuk merren direkt nga Shkrimet e Shenjta, por citohen nga përkthimi i një prifti katolik shqiptar të shekullit të pesëmbëdhjetë, na çon natyrshëm drejt dy përfundimesh: së pari, në misionet tona të krijimit të një shoqërie të shëndoshë ne jemi udhëhequr përherë nga individë, të cilët nuk kanë kuptuar nga pjesa tjetër e shoqërisë shqiptare, dhe së dyti, përmbushja e një misioni për ndërtimin e një shteti-komb, do të jetë përherë i pamundur nëse ne nuk do të

udhëhiqemi prej fillimit nga njerëz me ideale të larta. Ky trung i papërfunduar dhe i copëtuar me emrin *tokë shqiptare*, sikur të mos mjaftohej me tragjeditë e shkaktuara nga arsye krejt jashtë nesh, ka mbetur i tillë, edhe prej faktit se ne nuk arrijmë dot prej shekujsh të jemi dishepuj të prijësve të duhur të mendimit të lirë. Prijësve të ndriçuar nga burimi i së vërtetës. "Të vemi më shumë në klishë" është një thirrje për rikthim në vlerat dhe traditat më të mira të kombit tonë.

Bejko bën thirrje të vazhdueshme për ripërtëritje të vlerave, që me apo pa dashje, po i kryqëzojmë njëherë pas tjetër. Prandaj themi se poezia e tij vjen si shenjë ringjalljeje e njeriut, dashurisë dhe etnosit shqiptar. Poezia "Unë po ju them" e vëllimit "Si vdes gruri", rrimet drejtpërsëdrejti fjalët e Mesias para kryqëzimit. Të Dhjata e Re, në Ungjillin sipas Gjonit, lexojmë mesazhin e Zotit për mbarë njerëzimin në orën e tij vendimtare, pak para se të kryqëzohej: "Ora ka ardhur, në të cilën Biri i njeriut duhet të përlëvdohet. Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: nëse kokrra e grurit e rënë në dhe nuk vdes, ajo mbetet e vetme, por, po të vdesë, jep shumë fryt!"¹ Ringjallja

1 Bibla, Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e re, (2002). Libri



biblike e njeriut qiellor, përmes vdekjes së njeriut mëkatat tokësor brenda tij, fiton një funksion poetik të ngjashëm me mitin biblik te poeti ynë. Siç përcaktohet nga gjuhëtari formalist rus dhe teoricieni i letërsisë Roman Jakobson, funksioni poetik është "vendosja (Einstellung) ndaj mesazhit si i tillë, i përqendruar te mesazhi për hir të vetë mesazhit".² Njësoj si Mesia para kryqëzimit, shpirti i unit lirik të vëllimit "Si vdes gruri" është tejet i tronditur.³ Pas poezisë-prolog të librit, vijnë njëra pas tjetër poezi që rrëfejnë ishullimin e njeriut, barbarinë e vapës, angështinë e shpirtit, mjegullimin si moskuptim, vetminë, praninë e korbave e gjarpërinjve, dhembjet e dështuara, stërmundime sizifiane me shkëmbinj mbi shpinë etj. Bejko na kumton se ka ardhur ora të mos vdesim më. Ai po na thotë se kokrra e grurit e mbjellë në dhe jep shumë frute. Ky citim jep filozofinë se gruri që kalbet, mbaron udhën. Kokrra e gruri që vdes, jep tre a katër kallinj, shumohet dhe vazhdon udhën që e humbi i kalburit. Në filozofi ky quhet ligji i mohimit të mohimit. Biri që lind ka mohuar atin, por në momentin që biri lind një pasardhës ai ka vdekur, pasi e ka trashëguar tanimë udhëtimin te një tjetër. Ndaj fara mbillet në dhe për të rilindur, jo për t'u kalbur. Vërtet futet në dhe, por është nga ky lloji tjetër i vdekjes: vdekje me embrione të ripërtëritura.

Poezia "Cikli i mbyllur i Ikarit" në vëllimin "Letër Hamurabit" flet për harlisjen e një blerimi që pushton fushë e mal. Në këtë ripërtëritje plot bujë të bimëve e luleve, është dhe Ikarit. Ai rreh t'u vërë krahë gurëve, pllakave. Vjen vera. Bari është tharë dhe korrur. Ikarit është rrëzuar i përfunduar. Por cikli tjetër, ai i ripërtëritjes së natyrës mbetet. Përtëritja ndodhet përtej nesh ndërsa ne njësoj si Ikarit vërtitemi brenda një cikli të mbyllur, larg përtëritjes. Përherë në fluturime ndjellakeqe, që na lënë vuv në kufijtë e moskuptimit.


Ja... i rrëzuar tashmë,
po shpërndante dengjet e plagëve nëpër erë.
Fshatarët mbledhin dengjet me bar të korrur.
Pyeste: si e humba këtë stinë? Isha vallë
përkrah me të blertën në qerthullin e madh?
tashmë bari i tharë, fluturimi i lodhur,
krahët të korrur.

Shëmbëlltyra e mbjellësit biblik vjen këtu shumë e kamufluar. Sepse ne në vend të mbillemi si kokrra e grurit, për të fituar një vdekje me embrione të ripërtëritura, padashur kemi korrur veten tonë. Në vend të korrimit vdekjen, jemi korrur prej saj. Në vend të projektojmë fluturime nga toka drejt qiellit, si simbol përtëritjeje dhe ringjalljeje, ngjirim krahë dylli dhe nga qielli i pavënë re brenda nesh, biem përdhe

1 Gjonit, Kapitulli 12, Vargjet 23-24. Tiranë: Shoqëria Biblike Shqiptare Sh.B.Sh.

2 "The Princeton Encyclopedia of Poetry and Poetics", Princeton University Press, Princeton and Oxford, 2012.

3 Në vargun 27 të Ungjillit të Gjonit lexojmë fjalët e Mesias "Tani shpirti im është i tronditur".



pas fluturimesh të lodhura. Legjenda e Ikarit në ndërthurje me mitin biblik i jep poezisë së Bejkos një përmasë universale dhe një funksion social të realitetit të vendit të tij, me njerëz që misionin në shërbim të shoqërisë e ngatërrojnë me egoizmin personal. Ikarët që bien e bien pa pushim mos vallë janë prijësit e dështuar që e lënë përherë cung atdheun tonë të copëtuar?

Gjuha bëhet e dukshme në këtë poezi përmes mosrealizimit të misionit. Në të vërtetë nuk bie një Ikar i vetëm. Është një renie e pandërprerë ikarësh në tragjeditë tona të pandalshme kombëtare. Bie poeti dhe bie e tërë shoqëria. Bie shoqëria dhe nuk ngrihet dot më poeti. I mbetet të klithë përmes këngës mëpastaj. Ik-ari i tij është një ikje nga ari i shpirtit. Ikar i tij është Ikar i ynë. Por ky Ikar ynë, nuk është kurrsesi Ikar i tij. Poeti nuk ngjit krahë fantazmagorikë në fluturimin e tij drejt qiejve, por zgjedh të vdesë në krahë fluturë. Kështu gjuha e poezisë së tij jep shenja të forta feksese të ringjalljes. Poezia “Vdes në krahë fluturë”, si pjesë e ciklit poetik “Në karhë fluturë” në vëllimin “Letër Hamurabit” jep një atmosferë të tjetërllotë fluturimi e rënijeje të lirë prej makthit në paqe.

Vdes në krahë fluturë

*Në ditën, mollë e rrumbullt e kuqe,
me mish nate të ëmbël
hap tunelin
dhe vdes në krahë fluturë.*

Poeti nuk është Ikar që u vë flatra gurëve, as shpërndarës i plagëve nëpër ajër. I rri larg cikleve të mbyllura të dhimbjes e zhgënjimeve. Dita dhe nata janë njëlloj të ëmbla për të, sepse nuk mbjell ngrehina makthesh për vete dhe të tjerët nëpër ajri, por hap tunele në shpirtin e tij për të parë më qartë, se cila është ajo vdekje që do të përjetohet si rilindje dhe jo si rivdekje. Zgjedh të vdesë në krahë fluturë, ndoshta në një rrotullim përfaqësues, apo përhumbje në pjalmime fjalësh të deshifrueshme si duhet, nga ata dhe vetëm nga ata, që e kuptojnë si duhet fluturimin e Ikarit, që kur ai ngjizet si mendim, pa mbërritur fare te ankthi i plandosjes përtokë.

Gjuha poetike që bëhet e dukshme përmes shenjave të ringjalljes, në rrafsh sintagmatik (social) dhe paradigmatic (universal), nuk ngjizet përherë nga një humus qiellor. Ajo mund të jetë e dukshme në mënyrë deklamative, si në poezinë “Ç’mbeti pa thënë për dëshmorët”.

*Po ç’kish mbetur pa thënë për dëshmorët?
Me atë mbi shpinë hëngra rrush atë ditë,
gjaku i tij m’u tha në gjoks dhe në shpatull,
u mpiks kokrra-kokrra si xhamadan i kuq,
opingat më ishin mbushur me ugar vjeshte.
Po shefat donin heroizma, balada prej lumi
me bojë të kuqe, jo prej gjaku.*

*Kishin bërë luftën,
por kishin humbur paqen.*

Po ç’kish mbetur pa thënë për dëshmorët?

E pathëna bëhet e dukshme përmes të thënës në këtë poezi patriotike. Kemi poetin që shprehet se “opingat më ishin mbushur me ugar vjeshte”. Opingat pra i qenkan mbushur me vdekje dhe qenka e thënë që njeriu shqiptar të ecë me vdekje nëpër këmbë, edhe kur të rënë për atdhe janë në lartësinë e misionit të tyre. Edhe kur derdhin gjak dhe vdesin në krahë fluturë. Edhe kur nuk janë Ikarë. Se shefat duan heroizma prej boje të kuqe, jo prej gjaku. Të bësh luftën, por jo të fitosh paqen, është një mallkim

që e ka ndjekur kombin tonë ndër shekuj. Sepse liria ndër trojet tona, e mbjellë prej individësh të veçantë, është mohuar prej ikarëve që më shumë se gjakun (jetën), kanë dashur vdekjen dhe terrorin. Kush mohon gjakun, pjell diktaturën. Ata, shefat, që frigojnë të thonë për dëshmorët ato që duhen thënë, e kryejnë këtë akt makabër, me qëllim që populli të mos e mësojë dot kurrë kuptimin e lirisë së vërtetë. Ata bëjnë sikur e duan lirinë dhe krijojnë kështu skllavërinë e popujve. Duke mos e kuptuar lirinë si duhet, shoqëria izolohet dhe plakët, vdes pakuptuar se po vdes. Është ai lloj procesi që Arendt e përshkruan me këtë abstragim tejet thelbësor: “Ajo që e përgatit njeriun për dominimin totalitar në botën jo-totalitare është fakti se vetmia, e përjetuar si përvojë borderline (e personalitetit kufitar), e cila zakonisht ndjehet në kushte të caktuara marginale siç është pleqëria, është bërë një përvojë e përditshme...”⁴ A nuk u vetmuam ne prej lirisë për plot gjysmë shekulli? E si mund të ndodhte ndryshe kur të pathënat trajtoheshin si të thëna dhe të pathënat si të thëna për një kohë aq të gjatë? Bejko rrok pikërisht këtë përmasë të mohimit të lirisë në këtë poezi dhe në plot të tjera të ngjashme me të.

Në vëllimin më të fundit “Këngë të Solomonit”, në poezinë “Mos më lexo në mbrëmje Magdalin”, poeti iu drejtohet në një dialog të hapur, dy prej figurave femërore të traditës judeo-kristiane, Sulamithit dhe Magdalinit. Referencat e mitit biblik nuk mungojnë as këtu. Sërish poeti e tjerë poezinë më kumte të ringjalljes. Që në fillim citohet vargu biblik “Me vdekje vdekjen shkeli”, i cili nënkupton ringjalljen e Krishtit prej së vdekurish. Në poezi gërshetohen dy plane, ai vertikal që të çon te ngjarja biblike para dy mijë vjetëve dhe ai horizontal që e sjell ngjarjen në ditët tona. Rrëfimi ndërpritet nga komenti lirik i të gjallit në një natë pus me të ftohtë, me zogj që rrëzohen me akuj në sqep. Një i gjallë që nuk pranon të vdesë veçse si gruri. Rrëfimi vertikal është i thatë, pasi ndërkallet në tekst vetëm në funksion të rrëfimit horizontal. Ky i fundit, drejtuar Sulamithit dhe Magdalinit është plot ngjyra jete. Po ta aktualizojmë këtë formë dialoguese në rrafshin sinkronik dhe diakronik të shoqërisë që e ka përkundur dhe tronditur poetin si bir dhe krijues, themi se atdheu torzo, nuk mundet të përtërihet ndryshe, veçse më harmoninë absolute që sjell dialogimi mes prijësve të idealeve të mëdha dhe grave që ushqehen po nga të njëjtat ideale. Magdalena biblike kthehet në udhën e së vërtetës pasi dëgjon dhe kupton fjalët e Krishtit, ndërsa Sulamithi është dashuria e përsosur e gruas si shpirt dhe trup. Të dyja së bashku, këto gra judeo-kristiane përfaqësojnë gruan e mençur që rend pas fjalës së mençur dhe dashurisë së ringjallur. Burri dhe gruaja si skajet e të njëjtit litar ankthi, kur shoqëria shkon drejt kryqëzimit të vlerave. Burri dhe gruaja si idealet e emancipimit të një shoqërie jo vetëm shqiptare. Bejko çmitizon për të na rrëfyer se mjegullat e miteve dhe baladave nuk janë aty thjesht për të na mahnitur, por edhe për të na i tronditur thelbet tona të topitura në barbarinë e vapës moderne, ku ajri i kryqëzimit duhet të jetë rrënjë e këngë e një ringjalljeje kolektive. Vizionet halucinante patjetër duhet t’ia lënë vendin vegimeve vizionare. Poezia vetëm kështu i rifunksionalizon thelbet e kalburës në thelbe të përtërita.

⁴ Arendt, Hannah. (1967). *The Origins of Totalitarianism*, London: George Allen and Unwin, p.478.

Në 138 vjetorin e Maks Brodit

Shënim për Maks Brodin

Andrin Kabashi

Hebreu gjerman-folës, Maks Brod, i lindur në qytetin e errët të Pragës më 27 maj 1884, është ai që bota e njeh si mikun më të afërt të Franc Kafkës. Mendoj se pos tuberkulozit, Kafka vuajti nga depresioni tërë jetën e tij, dhe duke marrë parasysh se të dy u njohën qysh nga adoleshenca e vonë, vërehet qartë se Brodi ishte mbështetësi më i madh që Kafka kishte në jetën e tij, deri në vdekje – madje edhe pas saj.

Me plotë gojë mund ta them se, tradhtia më e bukur në historinë e letërsisë, por ndoshta edhe më gjerë, është tradhtia e amanetit të Kafkës. Të gjithë e dimë se sa pesimist dhe sa vetëmohues ishte Kafka, sakaq arriti deri në atë shkallë sa që shkrimet e tij të pa imagjinuara më parë nga lexuesit, t’i hidhte para zjarrit e t’i jepte fund njëherë e mirë për t’u mos u gjendur kurrë më. Por Brodi nuk e bëri këtë. Ndoshta mund të themi se ne nuk do njiheshim kurrë me shkrimet e Kafkës, po të mos ishte për Brodin, ky tradhtar i jashtëzakonshëm.

Është e çuditshme në fakt, sesi Kafka nuk i dogji vet shkrimet e tij. Këtë mund ta bënte fare lehtë. Nuk është se tuberkulozi do e pengonte diçka që ai t’i bënte grumbull të gjitha letrat e t’u vinte flakën. Mendoj se këtu ka diçka tjetër. Ndodh shpeshherë që miqtë kuptohen vetëm nga një mimikë, vetëm nga një zë apo në raste të veçanta edhe pa shenja fare. Mund të ketë ndodhur që Kafka nga pesimizmi i tepruar, ta ketë urdhëruar Brodin t’i digjte shënimet, duke e ditur se ai nuk do e bënte kurrë, mirëpo brendia e tij e errët nuk e linte të qetë dhe nuk i jepte shpresë se dikush, diku në botë, apo hiç më larg se në Pragë, do i pëlqente e do i admironte shkrimet e tij. Mund të ketë ndodhur gjithashtu që Kafka nuk i dogji letrat dhe ia la Brodit, me të vetëm dëshirë dhe qëllim që ato një ditë ta shihnin dritën e botimit, ashtu siç edhe la në amanet: “Nuk them se mendoj se nuk ia vlen të publikohen.” – por megjithatë Kafka u mbyll në brendinë e tij të errët sikurse bënte gjithmonë, në fizikun e insektit kurriztrashë.

Në letra të shumta, Kafka na flet se, në fund të ditës, Brodi ishte mik i mirë, i besueshëm dhe i afërt – ashtu siç në të vërtetë duhet të jetë një mik jete. Ata pinin bashkë, hanin bashkë, flisnin bashkë për vajzat, madje edhe në plazh shkuan së bashku. E çka mund të donte një njeri më tepër se një mik si Brodi.

Shpesh mendoj me vete për miqësi të tilla si e Kafkës me Brodin, dhe jo rrallë shoh se herët a vonë, njëri nga të dy do e bëj i pari aktin e tradhtisë, sado të afërt të jenë. Por sërish ndalem e them se, këtë radhë, tradhtinë Brodi e ruajti për në fund, dhe bëri një tradhti të mrekullueshme.

24.5.2022 – Prishtinë



s'duhet të harrojnë se për lirinë janë derdhur lumenj gjaku; se themelet e atdheut lartësohen edhe mbi varret e fëmijëve të lindur e të vdekur në të njëjtin vit, madje pa arritur të pagëzoheshin nga prindërit. Dhe duhet të kujtohet vargu i Dante Aligjerit: "Oh, kur e kujtoj se me sa gjak është blerë".

Prijësit, burokratët, nëpunësit, elitat dhe çdokush tjetër, që i shijojnë të mirat e kësaj bote, por ashtu si Midasi mitologjik duan që gjithçka e prekin ta kthejnë në ar, duhet të mendojnë se për të mirat e tyre dikush e ka përjetuar tmerrin. Duhet të mendojnë se ne jemi kalimthi në këtë botë dhe se një formë tjetër ekzistence mund ta sigurojmë vetëm duke bërë gjëra të mira që do t'i shijojnë edhe të paardhurit. Kështu mendojnë ata që punojnë për qëllime të larta. Ndryshe mendojnë ata që jetën e kanë lidhur vetëm me gjëra të përkohshme.

Romani i Bardhyl Mahmutit duhet të lexohet edhe për këtë qëllim. *Eskadronët e vdekjes*, përveç se është vepër letrare dhe na krijon kënaqësi estetike (që është qëllimi kryesor i letërsisë), na kujton atë që ka ndodhur dhe sikur na bën ftesë mos harrojmë. Kush harron atij i përsëritet tmerrin i historisë.

Derisa shkrimtari Danilo Kish mbante ligjëratë për Holokaustin, vërejtje se të rinjtë s'e kishin idenë se çfarë kishte ndodhur. Atëherë ndjeu obligim moral të rrëfente për të keqen, që ajo mos harrohej. Prandaj e shkroi romanin *Varrezat e Boris Davidoviçit*.

Ata që do ta lexojnë romanin *Eskadronët e Vdekjes* të Bardhyl Mahmutit besoj se do t'u zgjohet respekti dhe empatia për të rënë.

Romani, veç tjerash, i bën një nder të madh kulturës dhe letërsisë shqiptare, sepse aty nuk ka shovinizëm dhe urrejtje. Njerëzoria i bën nder të madh letërsisë shqiptare. Madje, autori romanin ua kushton intelektualëve serbë që guxuan të flisnin për gjenocidin në Kosovë, siç janë: Natasha Kandiç, Miroslav Filipoviç, Sonja Biserko apo Slavko Quruvija.

Derisa e lexoja romanin shpesh më ndodhte të kaplohesha nga ekstazat e leximit. Shpesh shënoja margjinave ndjenjat e mia. Më lejoni të ndaj ca shënime që nuk janë shkruar me gjuhën e profesorit a studiuesit; pra nuk janë shkruar me gjuhën e ftohtë, që i themi metagjuhë ose gjuhë e zakonshme që flet për gjuhë artistike. Janë shënime që i ka shkruar dhembja njerëzore për të rënë, të cilëve duhet t'u shprehim respekt dhe nderim të përhershëm. Duke i nderuar ata e nderojmë edhe vetveten...

Pushoni në përjetësinë tuaj. Askush s'mund t'ua cenojë lavdinë. Ajo është si era e lehtë sipër lules, sipër fluturës që dallohet me ngjyrat shkëlqyese. Është si ajri i pastër që na mbush me frymë kur bota është e ndotur. Është erë e përjetshme, e tejjetshme, e këndejjetshme, si fryma juaj... Pushoni në përjetësinë tuaj, ju që e deshët lirinë më shumë se jetën, ju që na ushqeni me ëndrrat tuaja sa herë privohemi nga liria. Pushoni në përjetësinë tuaj, askush s'mund t'ua vjedhë lavdinë, siç tha Bajroni. As oratorët që fshehin ligësinë me fjalë të qëndisura. Pushoni në çlodhjen e përhershme se jetën e patët me trazime. Gjithçka që u mbeti është lavdia, e cila emrin ua mbart ndër mote...

Romancierit Bardhyl Mamuti duhet t'i shprehim falënderimin tonë që na kujton atë që nuk duhet dhe nuk guxojmë ta harrojmë. *Eskadronët e vdekjes* është homazh, respekt dhe nderim për të rënë, të përvuajturit. Është roman për fituesit moralë - viktimat. Ky libër le të na shërbejë edhe si nxitje për të shkruar për temat që trajtohen aty. Lufta e Trojës krijoi letërsi të madhe. Edhe Holokausti lindi vepra të mëdha. Këto vepra duhet të shkruhen edhe për luftën e Kosovës.

THE ITALIAN JOB

nga Arben Dedja

Tunel

Ky tunel i gjatë ku unë – fëmijë kaloja i kënaqur me trenin e pushimeve të korrikut është vagina e mëmës sime teksa lindja


dhe kjo vërshëllimë nga terri i tunelit trembur është vërshëllima e trupit tim të lubrifikuar duke rrëshqitur kofshëve së sime ëme

ndërsa ajo dritë e largët në fund të tunelit ajo dritë që të merr frymën që afrohet shpejt e bërë shpellë ngjyrash është vdekja vdekja e bukur që po e pres.

1977

Ndonëse në rrugë kalonte një makinë çdo gjysmë ore arriti ta shtypte një djalë mosha ime tek më kishin çuar të blija bukë

dhe me lot gëzimi më pritën kur u shfaqta te shtëpia e gjyshes.



Elegji mizore për babain

1
E lava babain e vdekur një mëngjes marsi me cikmat e dimrit ende nëpër këmbë dhe pikërisht nga këmbët ia fillova – ujë e sapun – gjersa mori era myshk e pastaj rrëzë kofshëve sa ia fshika herdhët me këtë rast parë për herë të parë i veshja këmbëshë e kostum më të mirin duke ia mbajtur herek kokën mos ngjishej për gjoksi bukur e shtriva të paorë të paunaza i kreha pastaj thinjat e rrova në të thatë zor e pata me këpucët e reja tre-bishta-lugësh-shkukur dhe në fund kravatë i vura pasi bëra më parë nyjën në qafën time.

2
Ati im kur ti vdiqe të mbajtëm njëzet e katër orë pa varrosur të të bënim nderet e fundit një përgjim të gjatë por ndërkaq dimri po e linte tokën ndaj e fikëm ngrohjen në mesnatë ashtu te njëri-tjetri kruspulluar tek dikush spërkaste me parfum dhomën korridorin kuzhinën dhomën tjetër gjithë botën...

3
I ndjeri ati im kur ti vdiqe ishte sipërmarrje e vështirë të të zbrisnim shkallëve të pallatit me punë vullnetare të kohës së enverit një kusho i shtatë kacavarur tek telat e dritares së komshiut u mor me drejtimin e operacionit marangozi i katit të pestë i stërmati me metër këndet e kalvarit dikush dëshmor vuri shpinën poshtë qivurit por prapë e thyem që e thyem llambën e shkallëve skërfitem suvanë teksa brenda ti lëvizje thes me arra ngjisheshe pas kokës që sipas zakonit duhet të dilte e para.

Bizhdollan

Shtrirë në kokërr të shpinës brenda në water e gjeta bizhdollanin e zi – bankier i përgjumur në pishinën e tij – në zemër të kësaj nate.

O Deludh Universal o galixhant vepro ti në këtë botë pllakash majolike tek me shapka të zvergura iki si Zoti më galant?

1974

Ngandonjëherë babai vinte në shtëpi me kanotierë të gjakosur "Ja, pati një problem në sallë..." ose "Kishim operacion të madh..." Nëna nuk qe e kënaqur se gjaku nuk pastrohej kollaj dhe ia vinte në dukje me ato mënyrat e veta.

Ah baballarët dinë të lënë mbresa te bijtë dhe jeta është plot të papritura.

Ungji Llazar

Më shpupurishi flokët tek bëri përpara me një të ecur të çuditshme hopthi njëlloj këmbët e pantallonave njëra nga këpucët më e vogël iu afrua karriges e pa shtrembër karrigen uli dorën një sustë të padukshme shtypi nën gju dhe e dhathta u përkul.

1969

"Kujdes" më thoshin "arixhinjtë se vjedhin fëmijë."

Dhe unë që luaja me ta...

Vërtet që i vidhnin: kish aq shumë fëmijë në kolibet e tyre.

Por mua më lanë brenda muresh të lyera...

Kravata e peshkut

Pavarësisht këmbënguljes, ai nuk donte. Spërdridhte bishtin rrëshqitshëm mes gishtave të të zotit, rrëmbyer nga ideja se po bënte rezistencë, por si shumica e rezistentëve, ngjante qesharak. Ndonëse nuk kujtonte asnjë tjetër si vetja dhe mendonte mos ishte banori i vetëm i botës, diçka nga diku i thoshte se ajo copë e shkurtër (për të shumë e gjatë) lëkure me një majë në fund, ishte krejt e papërshtatshme dhe e bënte të dukej jopeshk (barbar, nëse peshku do të ishte jogrek i vjetër).

Me shumë mund, jo prej spërdredhjeve, por nga e qeshura, i zoti ia mbërtheu mes velëzave filispanjën e hollë ku qe lidhur kravata dhe e hodhi sërish në akuarium, kur peshku thua se po e humbiste frymëmarrjen. Me të marrë veten, u përshtat me mikun e ri. Duke qenë se nuk kujtonte asgjë nga jeta para kravatës, për të ajo ishte një vetvete e vogël që i vihej pas trishtueshëm, duke kërkuar prej tij t'i shpjegonte botën. Një e sjellë e plotë në skajet sferike të akuariumit; aq i zgjaste kujtesa, ndaj pareshtur i tregonte për vendet magjike: rrëpirën e zezë (çka është skaji lindor i televizorit), rrafshinën ngjyrëkafë (çka është tavolina e vogël me tre këmbë, trashëguar nga gjyshi), fundin e botës (çka është faqja e murit ngjyrëblu) dhe pafundësinë e shpresës (çka është pjesa përballë asaj faqeje të murit ku kryesisht, rri familja gjatë ditës). Pastaj ulej në fund, mbështetej në të tillë mënyrë që mos ta mbulonte kravatën dhe i fliste për dritën, të vetmen gjë të pashuar në kokën e tij të vogël. "Ky është dielli!" mendonte se thoshte, pasi kishte harruar aftësinë e komunikimit me të tjerët e llojit të tij. "Kur ndezet, është ditë dhe ne jemi të lirë. Kur fiket është natë dhe vjen peshkatari."

Qe rritur në akuariume. Fillimisht, pati dalë nga veza brenda një kutie të hekurt me dy ose tre gisht ujë. Nga aty, e morën dhe e hodhën në një akuarium të madh ku rrojti pak, pasi e blenë dhe prej tre vitesh, ose katër, jeton në sferikun të cilin tanimë e njeh si mëmëdheun e tij. Ndaj, është vërtetë e çuditshme ku kishte mësuar për diellin dhe peshkatari. Me gjasë, e ka me të dëgjuar, po nga kush? Qysh prej peshkut të fundit me të cilin ka bashkëbiseduar, kujtesa e tij është formatuar mijëra herë.

Pak ditë kaluan deri kur ra tërmeti. Qe i lehtë, ndaj të gjithë shpëtuan. Por akuariumi u thye. Një herë, në majë iu krijua një cufosje e vogël prej tapës së njëres nga shishet me alkool që i rrinin mbi kokë, por kur u mbështet i zoti i shtëpisë në të, pasi i merreshin mendtë, ai u thye i tëri. Peshku ra në tokë dhe flegat me zor i hapeshin e mbylleshin prej kravatës. Dikush mbushi me ujë një gotë dhe e futi aty ku qe i detyruar të rrinte i kruspulluar, si krimbi në grep. Pastaj e futën në një tas me ngjyrë të kuqe; bota e tij e re të cilën ia shpjegoi kravata që tashmë, në sytë e tij, ishte rritur goxha. E kishte të vështirë ta kuptonte, po i shkante ajo mbrapa atij, apo ai mbrapa asaj.

Gjërat gjithnjë e më tepër po vështirësoheshin. Askush nuk kishte kohë për një angazhim tjetër. Ranë dakord, si familje, ta largonin peshkun. Por askush nuk mori përsipër ta vriste. Jo, vajza e vogël e futi në një qese me ujë, vegëzat e së cilës i lidhi në timonin e biçikletës dhe duke pedaluar, shkoi pranë liqenit. Ato qenë momentet më të lumtura për peshkun që kuptoi se nuk ishte vërtetë me kujtesë afatshkurtër, por qe kthyer në të tillë pasiqë asgjë e re nuk ndodhte, ndaj detyrohej të sillej rrotull së shkuarës si të ishte gjithnjë e tashme. Dielli i qiellit e magjepsi aq shumë, sa harroi t'i thonte kravatës të vërtetën.

Pastaj, bullduq. Nuk ishte më vetëm me kravatën. Qindra, mijëra si ai, me ngjyrë të

KATËR TATUAZHE BRENDA NJË LIBRI ME TREGIME

nga *Andreas Dushi*



ngjytë, krejt ndryshe prej tijës, e rrethonin të frikësuar. Menjëherë iu kujtua gjuha, u foli. Ato u mahnitën, theksi i tij ishte ndryshe dhe sipas tyre, ishte theks mbretëror, prandaj e vunë në krye. Për to, kravata qe shenja dalluese e fisnikërisë së tij.

U tregonte çdo ditë për jetën e mëparshme dhe as që e vinte re kur dikush mungonte, pasi ishin aq shumë dhe të gjithë njëllor, por secili prej tyre e vinte re nëse ai mungonte pasi ishte vetëm një dhe krejt ndryshe, por veç kur e kuptuan këtë, njohën të ndryshmen. Prandaj i shkuan pranë, ia tërhoqën kravatën, ia shkëputën velëzat dhe e vranë. Pastaj vranë njëri – tjetrin, duke luftuar për kravatë. Pastaj peshkatari vdiqën nga uria. Pastaj u përhap kolera nga trupat e tyre të pakallur mbi dhë. Pastaj erdhën peshq të tjerë. Tisi i jetës ra prore mbi atë vend. Deri kur njëri syresh, diku mes guralecëve, gjeti kravatën. E vuri. Sundoi. E kuptuan se ishte ndryshe. E vranë dhe i morën kravatën. Pastaj vranë njëri – tjetrin duke luftuar për kravatën. Pastaj peshkatari vdiqën nga uria. Pastaj u përhap kolera nga trupat e tyre të pakallur mbi dhë. Dhe bota u rrotullua pambarimisht rreth boshtit të saj: kravatës së një peshku dhe diellit të saj: halave të një peshku.

Alpinisti

Prej vitesh ëndërronte të ngjitej. S'ishte marrë asnjëherë me aplinizëm, prandaj frikësohej jo pak. Maja, tepër e thepisur, gjithnjë i dukej se do t'i ngulej në zemër, sapo ta arrinte. Madje, shkante më tej, kur thoshte se as të ulte sytë s'do të mundej: një rrëshqitje e lehtë këmbë, një mbushje

me ajër dhe kaq! Pastaj, maja në mes të kraharorit, për ta shpuar tejprtej.

Por atë prag mëngjesi, kur petku i errësirës nuk ishte mbledhur akoma, i tha vetes se ishte koha e duhur. Ndoshta nga ndonjë forcë e mbinatyrshme, u bind se o tani, o kurrë do ja dilte. Sigurisht, idea se mund të vdiste e frikësoi. Gjithsesi, i tha vetes, në mos e stërmendofshim, ç'është vdekja? Kurrëgjë përposë një pikëmbërritjeje, njëjtë si maja e malit. Ne e vonojmë ngjitjen, por harrojmë se ajo, po u shkëput, bie vetë mbi faqen ku jemi kapur ne e, pa pritur e pa pyetur, na ngulet diku mes barkut dhe qafës.

Hodhi hapin e parë. Mandej të dytin. Të tretin. Pas tij, nuk i numëroi më. Eci, pa e kthyer kokën pas, deri në rrëzën e malit. Si ngriti sytë lart, u mbështoll prej një dëshire, gati epshi, për ta gllabëruar majën. Donte ta përfaqonte, puthte e, po t'i gjente ndonjë vrimë, mjaftueshëm të gjerë, ta përdhunonte. Sytë ju fandaksën, duart e fleshkëta ju forcuan, këmbët i nxorrën flatra, prej vërteti, jo si metaforë. Krejt pa e kuptuar, me shpejtësi të marrë, u ngjit. As nuk e ndjeu jargën t'i rrëshqiste nga goja në gjoks e prej aty, bashkuar me djersë, në pulpën e çarë vende – vende për hir të atij terreni plot mprehtësira.

Maja qe zhgënjim. Nga përballë, e kuptoi se ajo ishte e rumbullakosur, e mbi gjysëmshferën e zbrazur, dielli i sapodalë, pasqyrohej në formën më ideale, porsì një rreth i përsosur ngjyrëverdë. Mu në qendër të tij, një vrimë jo dhe aq e vogël, por veç mendimi se ja vlente ta fuste brenda asaj, e topiti dhe neveriti.

Vendosi të ulej, e gjithë zbritjen kujtoi me sa dëshirë e guxim, forcë e besim u

ngjit. Edhe se si, në ç'kënde e kishte parë nga poshtë majën, si ishte e mundur që i qe dukur aq ndryshe nga sa vërtetë ishte.

Kur arrin majën, fillon zbritja. Prandaj, asnjëherë s'duhet synuar maja, por rruga që ajo të ofron. Për sa kohë në fund ka një lloj morali a mesazhi, ky tekst i shkurtër i ngjan atyre të mesjetës. Nuk ka gjë! Në mes të jetës ishte edhe personazhi ynë.

Tre tentativa dhe një cigare e gjysëm

Herën e parë kur ishin bashkë, nuk ndjenin sigurinë e duhur. Gjithçka mund të ishte e tepërt, e hershme, e parakohshme. Ndaj, kur në mirëkuptim të plotë u ngritën nga krevati pa bërë gjë, shtrënguan mes dhëmbëve nga një cigare. Por nuk e ndezën. Ajo e tha "Një jociqare pas joseksit". Qeshën, u puthën, u ndanë.

Herën e dytë, e njihnin më mirë njëri-tjetrin. E gjitha shkoi mirë, qe një seks shumë i këndshëm për të dy. Si u mbështetën për ballin e krevatit, u panë në sy e qeshën: "Tani po, cigare pas seksit." I ndezën dhe i pinë.

Herën e tretë, nuk shkoi mirë por as fare keq, edhe pse "as fare" është si të thuash krejtësisht. Seksi u ndal në gjysëm, një porosi erdhi dhe e gjitha mori fund. "Është okay" – tha ajo – "një gjysëm cigare pas një gjysëm seksit." dhe e thithi veç katër herë, pasi e ndezi, për ta fikur sapo arriti gjysmën. Qeshën, u puthën, fjetën.

Dritarja e banjës në katin e katërt

Banoj në një pallat të vjetër pesëkatësh. Akoma i pasuvatuar, tullat e tij të trishtuara nga plakja ruajnë qindra duar të cilat prekën në tentativat e dështuara për restaurim. Nga dhjetra dritaret gjithmonë të mbyllura, bien lotë të boshtë vetmie. Qysh se jam lindur, në katin e tij të katërt, hyrja perëndimore, ndodhet apartamenti im, i gjallë dhe i gëzuar.

E mendoj shpesh pallatin si një qenie. Vetëm hapat e mi ndihen dyshemeve; veç zëri im jehon mes mureve; veç sytë e mi shikojnë hapësirave; veç hunda ime nuhat dhomave; veç lulet e mia gjallojnë ballkoneve. Duket sikur shpirti i saj është mbyllur për të mos dalë më brenda apartamentit tim në katin e katërt, hyrja perëndimore që u mburret shokëve e shoqeve të tij, dikur vëllezër e motra me të.

Banjot, të gjitha, rreshtohen njëra mbi tjetrën në të pesë katet e pallatit. Pa vështirësi vendi tyre dallohet qysh jashtë: dritare të ngushta në formë drejtkëndore zgjaten drejt tjetrës mbi to, si të ishin duke lypur dritë. Veç ajo e katit të pestë është fatlume: e gjen dritën. Nga njëra syresh, shpirti kundron hijen e trupit.

Shoh lart. Kryesisht qielli është i kaltër dhe aq i çelur, sa edhe zogjtë më të vegjël a dallëndyshet më krahëshkurtra bien si shi ngrash mbi sytë e mi. Kur është i vranët, hy brenda. I druhem shiut të pangjyrë.

Shoh drejtë. Të ngjashmit e trupit ruajnë të ngjashmit tim të cilët shpesh, ndeshen për trupin. Sa keq për trupat që kanë shumë shpirta.

Shoh poshtë. Hija e trupit tim shtrihet mbi të ngjashmit e tij dhe derdhet në tokë. Hija ime gjëkund nuk duket. Lufta e pagjasë mes të qenës dhe të paqenës hedh shakshka niseje, por asgjë. Hy brenda dhe kyç dritaren e banjës. Për asgjë, asnjëherë nuk ka shërbyer.

KATËR QEN TË BARDHË

I

Katër qen lëshohen rrufeshëm drejt meje, me më prishë. Dy të mëdhenjtë më arrijnë në mes të vreshtit. Kam veç një shkop frashni në dorë. U hodhën në ajër, me më shqye, por i prita me shkop kresë, njërin mbas tjetrit. Ranë coftë në tokë, bashkë me copat e shkopit, që u thye në goditjen e dytë. Po atë grimë, ndjeva prapa thembrave kafshimin e qenve të vegjël. Nuk i shmanga dot...

II

Me del gjumi, por ende ka natë. Nga frëngjia e vetme e qelisë hyn thëllimi me kundërmimin e dëborës së parë. Vjen së largu, si e bjerrë, kënga e gjelave të tretë. Pas 9 muajsh hetuesi të egër po gdhin kështu dita e gjykimit tim. Me ato 4 nenet e tmerrshme... dhe atë, dëshmitarin kyç, Veli S...! Sa qen m'u shtirën në ëndërr? Katër... Të bardhë, të bardhë... Aq sa nenet e akuzës sime: dy të mëdhenj, të frikshëm, dhëmbëçataj e sykuqë, dhe dy të tjerë, të vegjël, me dhëmbët brisk. Si nenet e akuzës sime: dy që të marrin jetën, dy të tjerë që të marrin disa vite jetë. Me bashkim nenes, të çojnë në pushkatim. Pjesa tjetër dihet: pleqtë, gruaja, pesë kalamajtë... dhe rrugët e pasosura të internimeve... Por, në qoftë se 4 qentë e ëndrrës janë 4 nenet e akuzës sime, puna nuk është keq. Kurrë nuk i kam besuar ëndrrat. Por sot... sot s'kam ku të kapem.

III

- Këtë kokë, zëre se s'e ke më tëndën! Do të ta shkulim prej supeve, si një rrepë! – më kërcënon ndër dhëmbë hetuesi im, kapiten Kote. Nuk i kthej përgjigje. Habitem me ndjesinë e mirë që kam përbrenda. Sallë gjyqi. Fytyra krejt të panjohura. Fillon seanca me nenet e vogla: 1. "Moskallzim bisedash armiqësore dhe pengim të organevet hetuese" dhe 2. "Armëmbajtje pa leje". Mbrojtja ime bie ndesh me dëshmitarë dhe prova. "Dy qentë e vegjël të ëndrrës kafshuan", - mendova. Gjithçka e vendos seanca e pasdites.

IV

Lexohet akt-akuza: 1. "Tentativë arratisje në grupazh" dhe, njëkohësisht, 2. "Tradhëti e lartë ndaj atdheut".

- Fillojmë me zbardhjen e provave dhe rrethanave, – thotë kryetari. - Të hyjë dëshmitari!

Nuk ndjej asfarë paniku. Veli S., nuk po duket ndërsa koha kalon. Pëshpërma. Hyn një police e bukur, elegante, sikur po shkel mbi vezë. Shkon drejt bankës së akuzës. Kryetari zgjat kokën e thinjur. Qafën e ka ezmore, me rrudha; fytin me arrëz. Si një breshkë. Policija i çuqurit në vesh. Pa gjeste. Ai tund kokën. Mandej, fill pas largimit të vajzës police, thotë: "Të vazhdohet përkohësisht me të pandehurin!". Marr krahë. Refuzoj gjithçka. Gjithçka. Të qena e të paqena.

- Janë shpifje të gjitha, - them, - thirrreni dëshmitarin t'jua provoj!

Dëshmitari nuk vjen. Trupa tërhiqet për të marrë vendimin.

V

- Ia hodhe, skile! Të ndihmoi fati "me pak", - u skërmit hetuesi im në korridor. - Por, mos kujto se na shpëton, - tundi gishtin me një gjest kërcënimi të fshehtë. - Herën tjetër, kaptinën tënde do të ta shkulim supesh...

BORË E ZEZË

tregime nga Agron Tufa



- Si një rrepë? – e ndërpreva.
- Pikërisht!
- Ruaj kaptinën tënde, kapiten... Timen e ruan Zoti.

VI

Policia që më shoqëron mbrapsht në Degë më flet me dialektin e vendlindjes:

- Sak ta ka ruejt Zoti kryet, or mik... Kujt i shkote ndërmen, se... dëshmitarin tat, do ta bantë petë makina, mu para gjykate?

- E shtypi makina!
- Sa ka hy zotnia juej në sallë...!
- Katër qen! - thashë nëpër dhëmbë.
- A? - pyeti policia me dorën si hinkë në vesh.

- Të bardhë, - i thashë.
- Të bardhë, çfarë?
- Dy të mëdhenj, dy të vegjël...

Policia ndalon papritmas. Kërkon në xhepa dhe nxjerr një paketë "DS". Merr një cigare dhe ma vë në buzë filtrin e verdhë. Mandej flaka e çakmakut me gaz. E thith thellë e me afsh tymin, derisa ndeshem me vështrimin e tij të picërruar, hetues.

- A je mirë, or mik? – pyet serioz ai, pa m'i shqitur sytë.

- Shëndoshë e mirë, - i them. – Gjallë!
Policia tund kokën i kënaqur, në shenjë miratimi.

Vazhdojmë rrugën, vetëm disa metra, deri në oborrin e Degës.

- Po, po, - miraton me zë lëvizjet e mëparshme të kokës, - S'ka me të gjallë...

BORË E ZEZË

Fatkeqësitë pllakosën në familjen tonë nga të gjitha anët. Ato fillojnë me borën e zezë që ra atë dimër, ditën kur vdiq nëna ime, duke më lënë jetim, ferrishte, një vit e tre muajsh. Më vonë, kur të rritesha, do ta mësoja se bora e zezë e atij viti përkonte me shpërthimin e vullkanit Vezuv. Të nesërmen e varrimit të nënës sime, arrestuan tim atë. Një kamion erdh të nesërmen dhe mori pjesën tjetër të familjes. Vendi i internimit – Berat. Lavdi Zotit që tri motrat e mia i morën në shtëpitë e veta bashkëshararët tanë. Unë, si fëmijë i mitur mbeta me gjyshen, të cilën e njihja për nënën time. Me ne në internim ishin daja dhe dy tezet, të cilat kujtoja se janë motrat. Në Tepelenë na çuan kur unë kisha mbushur 4 vjeç.

Nuk njihja shumë gjëra të ngrënshme, si sheqeri, djathi, qumështi, makaronat, e sidomos mishi. Mbjaj mend se gjyshja mbante një rrasë të lëmuar guri, të cilën e ngrohte, e ngjeshte në bark dhe e mbante të lidhur me brez dhe konop. Racionin e saj të bukës ma jepte mua. Ditën kërkonim në oborrin e kazermeve mos gjenim ndonjë kokërr gruri apo misri. Në lindje të kazermeve ishte një kopsht i rrethuar me tela ku rriteshin perimet e komandës. Si gjithë kalamajtë, edhe unë prisja mos na hidhnin ndonjë domate të kalbur.

Një ditë shkova vetëm dhe provova të hyj nën tela. M'u vërsul një qen i zi me pulla, që i thonin "Shark". Më sollën të lebetitur në kazerme. Nga analiza e kafshimit, doli se qeni ishte i tërbuar. Plaga u enjt dhe

duhej të më nisnin urgjent në burgun e Gjirokastrës ku kishte spital. Nuk pranuan të vinte me mua as gjyshen, as dajën, as njëren nga tezet. Përfundimisht më nisën vetëm. Mbjaj mend turbull një bodrum ku më futën, një qeli të muqët që kishte vetëm një krevat.

Për 6 muaj, sa kam qëndruar aty, më kanë rrahur papushim. Ishte një pastruese, një grua zemërrezë, që më rrihte me fshesë. Pa shkak. Kishte një kënaqësi sadiste kur më rrihte me bishtin e fshesës. Sa ia dëgjoja zërin apo hapat, nxitoja të fshihesha në krevat, poshtë batanijeve. Së paku bishti i fshesës do më dhembte më pak, i struktur nën batanije. Sa herë kam menduar, përse më rrihte ajo grua? Çfarë tërbimi i shkaktonte asaj një fëmijë katër vjeçar, jetim, i pambrojtur, pa asnjë njeri të tij përqark? A ka pasë vallë ajo grua familje? Fëmijë? Ju e kuptoni se sa të vërteta më janë dukur pastaj shtrigat e përrallave...

Kur më në fund më kthyen në Tepelenë, natë për natë vijova të trembesha në gjumë. Më ndiqte kudo ajo gruaja e tmerrshme me fshesë. Qaja edhe pas disa muajsh pas kthimit.

Unë e di që Gjirokastra është një qytet i bukur, me histori dhe stil urban karakteristik. Por unë ngjethem, sapo ia dëgjoj emrin këtij qyteti. Gjithmonë refuzoj të kaloj nëpër atë qytet, qoftë dhe kalimthi.

NË QOFTË SE VDES...

Hetuesi im i ri do të ishte një burracak me emrin Ali Xhunga. Shkurtabiq, karrierist e servil, zelli i tij i lig nuk njihte kufi mizorie. Nën torturat e tij u enda për tre muaj midis jetës dhe vdekjes. Më kishte thënë qysh ditën e parë të hetimit: "Jam i fundit hetues që merret me ty. Për të folur do flasësh, se s'bën, por me që je 19 vjeç, ke familje, je djali i vetëm midis 9 motrash, mos e ço punën deri atje... Se në fund ne s'pyesim fare as për jetën tënde, as të familjes. Motrat t'i bëjmë kurva, si të na teket. Ohoo, sa ka parë ky vënd, prandaja mendohu sa s'është vonë!"

Refuzimit tim për të bërë "proces", ai iu përgjigj menjëherë me gjeneratorin e korentit. Trupi im përplasej në shkundje e konvulse të forta. Veshët m'u bënë plagë. I majti rrodhi gjak. Ditët e tjera Ali Xhunga u shtoi torturave me korent edhe goditjet me një dru të shkurtër. Në kulmin e dridhjeve nga korenti, ai më godiste ku mundte dhe shfrynte: "Qenër! Prisni t'ju vijnë anglo-amerikanët tuaj, por ta dini mirë, se edhe sikur ata vërtet të vijnë, ne më parë do t'ju therim të gjithëve aty, ndër biruca ku ju kemi, birucë për birucë e një për një".

Torturave të korentit dhe goditjeve me dru iu shtuan varjet me zinxhir e litarë nga kyçet e nga sqetullat. Mishrat e kyçeve dhe sqetullave m'u çanë dhe nga goja kullonte shkumë e jargë. Ashtu të varur vinte e më godiste me drurin e tij Ali Xhunga, ndonëse trupi im gjithë plagë të hapura kutërbonte qelb, si një kafshë e ngordhur. Vetëm besimi në një vdekje të afërt më jepte forcë e durim. Nuk qëndroja dot në këmbë.

Dy policët që më merrnin për krahësh për në hetuesi, e mbanin kokën anash, nga muret. Njëri njëherë më lëshoi midis shkallëve, u kthye anash dhe volli.

Mandej erdhi dhe koha kur rrugën për në WC e bëja duke u mbajtur për muri, e kur s'pata më dhe aq fuqi, e bëja rrugën gjunjazi, këmbadoraz.

Në njëren nga këto vajtje-kthime në WC, u ndala në mes të korridorit të qelive, duke e ditur mirë, se prapa dyerve të burgosurit më ndiqnin. Thirra fort, para se policia të ma mbyllte gojën:

- Jam Ahmeti... Nëqoftë se vdes, ju lutem, tregoni se nuk kam bërë proces!

(Marrë nga "Kur këndonin gjelat e tretë")

Kënga e re

Poemë nga Nurie Emrullai

Kur të shërohem prej lemerisë së kohës,
do këndoj një këngë të re,
se unë s'do jem më kjo,
as dora ime
që shkund krahët halore të engjëjve.

Një këngë e re
do t'u këndohet dritareve të marrra,
teksa ti me thonjtë e bardhë të viteve çjerrë natën,
e nga vrima e çelsit do t'u këndohet dyerve të
përgjimeve,
teksa jetën tënde e mat me prekje
në shtratin ku u mbarse me të nesërme
dhe prekja jote nuk gjen fundin...
Se ajo nuk qe kurrë e nesërmja jote,
gjithnjë qe e atyre që i dhanë zë kësaj kënge,
që të bindën se ata t'i falën
edhe kohën edhe qumshtin edhe bukën...
Madje goja jote qe goja e tyre,
sytë e tu qenë shikimet e tyre,
dhëmbët e tu hëngrën mish nga mishi i tyre...
Andaj tani fillo ta vjellësh gjithë këtë trup që s'është
ti,
se ti je veç një kockë në të cilën mbahet varur coha e
hollë
ku gjithkush mund të shikojë se ç'përbindësh është
njeriu.

Kjo këngë do t'u këndohet trupave
që shpresa ua ndërkaq varret,
se gjithçka e mësuar gabim, nuk çmësohet më
e kjo folje as që ekziston –
fundja kush e di se ç'që e gabuar dhe e saktë?

Kjo këngë do t'u këndohet
të sëmurëve që nuk duan të shërohen,
që në ëndrra u faniten rrugë,
që i përpin tmerrin e trupit.

Do ta këndojë bashkë me mua këtë këngë,
ai që do të bëhet nënë për nënën e tij
dhe babë për babanë e tij,
dhe do të shpikë përralla për ata,
dhe do të shpikë një fat që nuk është,
dhe do të veshë po ato ngjyra
dhe do të qajë për ëndrrat e tyre...
Se traumat trashëgohen
dhe si në luftë ashtu edhe në natyrë,
e pëson gjithnjë më i vogli,
gjithnjë një këmbë e madhe
nuk sheh se kah shkel.

Do të përshkohet kjo këngë njerëzore
nëpër duar që s'vyejnë si duar, se ata që i kishin
krehën të nesërmen me thonjtë e tyre,
shkulën flokë dhe kujtesë.
Kjo këngë njerëzore do të vajtohet
nëpër sy që mbrujnë errësirën.

S'ka më erë të re lëkure,
ka veç erë mishi që kalbet -
teksa lexon këtë poezi,
teksa kundron hënën tej dritares sa sytë,
dhe kupton që vuan nga të gjitha sëmundjet.
Vuan edhe nga shpejtësia e ditëve
që vjellin marramendje me ngjyra,
me një diell që lind dhe perëndon në çast.
Shakullinë kjo jeta ime.
Ndal!
Ndal këtu!

Një këngë do të vazhdojë të nxjerrë tymin e shpirtit,
do të përvidhet nëpër oxhaqet e varfërisë.
Varfëria ime që s'mungon në tryezë
që mbrëmjeve fryn nga dritarja,
që mëngjeseve del nga dera.
Një këngë krenare
që unë po e vazhdoj e që fund nuk ka...

Kjo këngë
që unë e urrej se është gjithë e vërteta ime,
që më trishton se s'ka asgjë të bukur,
që më është e brishtë si krahët e fluturës,
që mund të merret si çmenduri...

Kjo këngë e përbotshme,
e lidhur me veten,
me hijen,
me pasqyrën,
e përmotshme...

Kjo këngë
që këndohet nëpër harpat e dhëmbëve të mi,
nëpër flokët e mia ku qan një violinë,
nëpër gishtërinjtë e mi që e luajnë fatin tim në dy
ngjyra...

Është qesharake se si mendoj
se kam për ta kënduar gjithmonë këtë këngë,
se kam për të qenë gjallë,
se zëri im ka për të qenë...

E imagjino se unë përherë do të jem majë kodre
dhe do të kundroj fluturat, zogjtë, xixëllonjat?
Fluturimeve të tyre unë arrij t'u buzëqesh,
veç ata e dinë sa herë provoj të fluturoj
dhe rrëzohem në mendjen time,
përplasem në gjakun tim
dhe lë shenja që as duken, as humben...

Kjo do të jetë kënga ime që gjëmon,
siç gjëmojnë zërat në Olimp nga frika e harrimit dhe
zhbërjes.
Gjithsesi diçka do të përcillet nga jeta në jetë:
ca pluhur perëndish tek njerëzit
dhe hiri im në këtë këngë.
Këngë e cila s'kërkon të mbahet mend,
e as kërkon zë të bukur,
përveçse një zemre të fortë për të çarë ditët e jetës,
njësoj siç çahet himena nga ku unë linda e para.

Këtë këngë do ta dëgjojnë
ata që do të presin dashuria t'u falet me dashuri
dhe shikimi t'u kthehet me shikim.
Do ta dëgjojnë ata që do të provojnë rritjen,
zhgënjimet e idealeve,
pritjet,
zërin që pas nuk u kthehet.
Atyre që qiriu u shuhet brenda dorës në një mot të
hirtë
teksa zgjohen xurxull nga ëndrrat.

Dhe,
kjo këngë do të dëgjohet,
pak para muzgu
kur era qetësohet, kur drita mbyll portat,
dhe mbi kokën e njerëzisë fillojnë e çelin hije...



*Përpara syve të mi lëkura ime po tendoset,
Teksa mbliidhet pas meje dhe formon një
nyje,*

*Dhe unë i tëri lakohem si një hark pers.
... Nuk gjendem në një vend të mirë, unë
nuk jam piktor.*

Michelangelo Buonarroti (1475-1564)

Këto fjalë të shkruara nga dora e Michelangelo na tregojnë një njeri të thyer. Krijuesi i njeriut-zot na shpaloset i rënë dhe i dërrmuar. Me Davidin, veprën kolosale, pas krahëve, me personalitetin tjetër që fshihet në ëndrrat dhe dëshirat e tij, si dhe në aspiratat vetë hyjnore të mbarë njerëzimit, Michelangelo rikthehet te vetja e tij si një genie vdekatare.

Dhe ky trishtim dhe përhumbje që e karakterizonte natyrën e tij e të mbarë racës njerëzore u duk qartë, e arrijmë ta dallojmë ende edhe sot, te kryevepra tjetër e mjeshtrit të daltës, i cili kësaj here i pajisur me penel e bojë, krijoi skenën më madhështore të kohërave, të gjithë historinë 6,000 vjeçare të qytetërimit brenda një salle, afreskun në kubënë e kapelës, dhe afreskun tjetër *Gjykimi i Fundit*, në murin ballor pas altarit, në *Kapelën Sistine*, Vatikan.

Kur qëndrova nën madhështinë e Davidit në *Galleria dell'Accademia* në Firence u ndjeva një njeri i vogël, një genie që shikonte një genie të re, një transformim të mishit në frymë hyjnie, por në *Kapelën Sistine*, i rrethuar nga afreske madhështore kuptova se isha vetëm një grimë e historisë, e asaj të shkruar e të pashkruar ende, të asaj që ka kaluar e asaj që do të vijë. Dhe me kokën lart për nga tavani dhe muret e larta, u ndjeva i përlur.

Çdo vdekatar i zakonshëm e ka tepër të vështirë të përfytyrojë sesi qe e mundur që një genie njerëzore të arrijë atë që arriti Michelangelo gjatë katër viteve punë, vetëm për vetëm, në skaleritë e faltores papale. Kolosal është qoftë edhe vetëm mundimi fizik për të pikturuar këtë afresk gjigand në tavanin e faltores, për ta skicuar e për të përgatitur detajet, dhe pastaj për t'i hedhur në mur. Afresku në kubënë e kapelës u pikturua për katër vjet, 1508-1512.

Si mund të qëndrojë njeriu katër vjet mbi skelë? Me kokën e përkulur nga pas në mënyrë të atillë që qafa iu kthye vërtetë vetëm në një kanal midis pjesës së pasme të kokës dhe shtyllës kurrizore; me mjekrën dhe gushën e ngritur tekta muskujt e qafës i kishte të ënjtura dhe të tendosura si litar; me shpatulla plot dhimbje, me krahët e lodhura për shkak se qëndronin lart gjatë të gjithë kohës; me fytyrën e shndërruar në një maskë groteske për shkak të bojës që i kullonte si shiu mbi fytyrë; dhe poshtë tij një lartësi prej njëzetë metrash. Katër vite punë. Katër vite torturë fizike, dhe një betejë e brendshme artistike dhe shpirtërore.

Askush nuk guxon të mohojë vullnetin dhe përkushtimin e shpirtit njerëzor të manifestuar në këtë vepër. Askush nuk guxon të mos duartrokasë për meritat e aftësisë, teknikën dhe mjeshtërinë artistike të kësaj vepre monumentale të Michelangelo, i cili në katër vite, edhe letrat që merrte i lexonte duke i ngritur lart, si pasojë e torturës fizike që iu desh të përjetonte për të pikturuar afresket. Ai kishte vështirësi kur ecte me vështrimin poshtë, mbante këpucët veshur për një kohë të gjatë dhe kur i hiqte merrnin me vete pjesë nga lëkura e shputës së këmbës. "Jam kaq shumë i trazuar dhe fizikisht i rraskapitur. Nuk kam shokë, e madje as që dua të kem," i shkroi Michelangelo vëllait të tij. Kjo sakrificë njerëzore, kjo bindje skllavëruese që mjeshtri bëri ndaj artit, sot mbetet një nga dhuratat më të çmuara që vetë arti na ka dhuruar ne për të kuptuar një fytyrë tjetër të tij, magjinë për të pikturuar të mbinatyrshmen përmes një dore vdekatare, aftësinë për të fotografuar të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, e gjitha në një moment dhe imazh të vetëm.

Janë mbi 300 figura në afresket e *Kapelës*



AFRESKET E KAPELËS SISTINE

Dr. Bledar Kurti

Sistine. Në to, të gjitha standardet njerëzore duket se janë tejkaluar si në qëllimin ashtu edhe në formë, dhe e paimagjinueshmja bëhet realitet. Ato kanë frymëzuar dhe tronditur të gjithë mendimtarët më të shquar të gjitha kohërave. Skenat e pikturuara janë rrëqethëse, që nga fillimi dhe fundi i botës; krijimi i dritës, lindja e jetës, origjina e mëkatit, dita e gjykimit, të gjitha të shprehura nëpërmjet formave të zgjeruara të trupit njerëzor. Vetë Perëndia është në këto piktura. Ai rri pezull si një re e madhe e bubullimë mbi një humnerë të errët, jo si një simbol i asaj që nuk mund të perceptohet, por si një shfaqje frike dhe

frymëzimi mbi natyrën dhe imazhin e njeriut. Ndërsa drita ndahet nga errësira, po kështu edhe jeta del nga mosgjëja. Adami ngrihet ngadalë nga gjumi i tij i gjatë dhe Eva buron nga brinjët e gjumit. Mëkati që vjen në tokë dhe errësira që mbulon dheun. Njerëzit janë të zhveshur përpara Perëndisë, të zhveshur si toka që nuk mbulohet nga asnjë fije bari. Shenjtorë e mëkatarë, shpirtra të zgjedhur dhe të humbur, profetë dhe profanë, të gjithë nën gjykimin hyjnor.

Sfida e Michelangelo nuk ishte vetëm realizimi i veprës, por presioni i tij i brendshëm kishte të bënte me vendin ku do punonte. *Kapela Sistine* gjendet në një

nga vendet më të shenjta të krishterimit, në *Bazilikën e Shën Pjetrit* në Vatikan. Ajo u ndërta mbi eshtrat e Apostullit Pjetër, i cili u martirizua në Romë nën sundimin e perandorit Neron, ndaj edhe ka këtë emër. Emri Pjetër, "Petrus" në latinisht dhe "Petros" në greqisht, rrjedh nga "petra", që do të thotë "gur" ose "shkëmb" në greqisht, dhe është përkthimi i literalizuar i aramaishtes "Kepa", emri që Jezusi i dha Pjetrit:

Atëherë Jezusi e shikoi dhe tha: "Ti je Simoni, bir i Jonas. Ti do të quhesh Kefa, që do të thotë: "gur". "Dhe unë po të them gjithashtu se ti je Pjetri, dhe mbi këtë shkëmb unë do të ndërtoj kishën time."

Duke interpretuar këto fjalë të Jezusit të krishterët e parë nisën të ndërtojnë faltore. Mbi këtë varr të rëndësishëm për krishterimin, perandori romak Konstantin ndërtoi një kishë të madhe që mbijetoi më shumë se një mijë vjet. Disa gravura të shekullit të 17-të tregojnë se projekti i kësaj strukture të krishterë të hershme ishte i madh dhe plani i tij me pesë shtylla hodhi themelet për *Shën Pjetrin* e ri. Planet për ta rimodeluar dhe zgjeruar bazilikën filluan në vitin 1450 dhe vazhduan për më shumë se 150 vjet. Ata u kryen nga një sërë papësh të përkushtuar për të punësuar arkitektët më të mirë të kohës. Dhe për të shpalosur lavdinë e kishës, më 18 prill 1506 Papa Julius II hodhi themelet e *Bazilikës së re të Shën Pjetrit* nën projektimin e arkitektit të suksesshëm Donato Bramante, dhe positi artistin fiorentin Michelangelo të pikturonte *Kapelën Sistine*.

... Nuk gjendem në një vend të mirë, unë nuk jam piktor, shkroi ai.

Dhe, vërtetë nuk e mbante veten si të tillë. Edhe pse në Firence ai ishte porositur nga paria e qytetit të pikturonte një murale përballë Leonardos, ai vazhonte ta konsideronte veten si skulptor dhe arkitekt, ndaj një sipërmarrje e tillë nuk i dukej përbushëse. Ne arrijmë ta imagjinojmë skulptorin me penel në dorë, pasi shohim format tek figurat në këtë afresk. Ato nuk janë të zbutura prej ngjyrave, ato janë trupa skulpturor, me siluetë të fortë e linja të vrazhda. Ndryshe nga Leonardo, i cili përmes sfumatos krijoi linjat dhe dritë-hijet më delikate në histori, Michelangelo duket sikur i ka pikturuar ato me baltë e gdhendur me daltë.

Vërehen plot defekte në figurat e afreskeve: koka të vogla në krahasim me trupin; gjymtyrë aspak proporcionale, për shembull, një krah apo një këmbë më e madhe se ç' duhet, apo një qafë më e vogël se ç' duhet; femra muskulore e mashkullore; pleq me trupa të palestruar sikur të ishin të rinj, etj. Por të gjitha të metat e figurave kanë rezultat në krijimin e një efekti të jashtëzakonshëm tre dimensional, pasi afresku nuk duket si një vepër me trupa të pikturuar por me skulptura që pluskojnë në kubënë dhe faqet e mëdha të mureve të larta, duke transmetuar një ndjesi shtesë dramatike dhe skenike.

Ndërkohë që Michelangelo i bindej thirrjes së artit për të krijuar përmes një zhanri që nuk i përkiste, edhe mjeshtri Leonardo, rivali më i madh dhe i përbetuar i Michelangelo, vite më parë në një letër të drejtuar sundimtarit të Milanos, Ludovico Sforza, i kishte listuar një sërë talentesh, si inxhinier, arkitekt, gjeolog, shpikës, etj, dhe vetëm në fund të letrës kishte shënuar se, "unë di edhe të pikturoj." Me sa kuptojmë, të dy gjenitë e nënvlerësonin pikturën, por ja që përmes saj ata krijuan veprat që do ndryshonin njerëzimin dhe do hapin një portë të re drejt universit të artit aq të panjohur e imagjinuar më parë. Ajo portë qëndron ende e hapur për ne, në mënyrë që të gjithë brezat të kuptojnë misteret e asaj që na rrethon, dhe aftësitë e asaj që fshihet brenda mendjes dhe forcës sonë.

Dhe porsia Leonardo, Michelangelo vuri shkencën në shërbim të artit. Në fillim të viteve 1490, kur ai ishte në të 20-tat e tij, ai përdori trupat e vdekur për të studiuar



strukturën e muskulaturës dhe skeletit. Studimet e tij anatomike prodhuan një art me autenticitet më të madh dhe fuqi emocionale si kurrë më parë.

Figurat e Michelangelo në kubenë e *Kapelës Sistine* konsiderohen disa nga imazhet ikonë të pikturës së Rilindjes. Tavani ndahet në 33 zona të veçanta, sipas numrit të viteve të Krishtit, dhe çdo hapësirë individuale është pikturuar me një skenë të ndryshme. Në pllakat qendrore, Michelangelo ka pikturuar historinë biblike të Zanafillës dhe figurat kapin menjëherë syrin e shikuesit që hyn në kapelë.


Ngrini sytë në atë tavan e do shikoni sesi Perëndia ndan ujin me tokën, krijon diellin, hënën dhe bimët, ndan dritën nga errësira, dhe krijon njeriun. Krijimi i Adamit është një ndër imazhet ikonë edhe në ditët e sotme. Është riprodhuar e përdorur aq shumë sa që edhe një markë celulari dhe telekomunikacioni e shndërroi në logon e saj: *connecting people*. Por, ndryshe nga perceptimi i brezave modern ky imazh ka si qendër dy gishta që preken, njëri mishor e tjetri hyjnor. Prekja e parë midis njeriut dhe krijesit të tij, babait të mbarë njerëzimit.

Krijimi i Adamit është imazhi më i fuqishëm në të gjithë afreskun. Dy gishta që preken është një shprehje madhështie e krijimit të njeriut, e ilustruar me një thjeshtësi e forcë të tillë. Adami qëndron i shtrirë me gjithë energjinë dhe bukurinë që i takon dhe që i takon burrit të parë të kësaj toke. Nga ana tjetër, Ati Perëndi po afrohet, i mbajtur nga engjëjt e tij, mbështjellë me një mantel të gjerë e madhështor të valëvitur nga era si një velë, duke dhënë kështu idenë e lehtësisë dhe shpejtësisë me të cilën ai qëndron pezull në atë hapësirë. Sapo ai zgjat dorën, madje pa e prekur mirë gishtin e Adamit, ne gati-gati shohim sesi zgjohet njeriu i parë i kësaj toke, sikur po del nga një gjumë i thellë, me sytë që vështrojnë fytyrën atyrorë të krijesit. Është një nga mrekullitë më të mëdha në art që Michelangelo, prekjen e dorës hyjnore ka arritur ta bëjë pikë qendrore të këtij afresku dhe që ka bërë të shohim e të ndiejmë idenë e gjithëfuqishmërisë, me anë të lehtësisë dhe forcës së kësaj lëvizje e krijimi. Kjo skenë është një prej simboleve më të shquara të artit të botës. Mes gishtit tregues të Hyjit dhe gishtit të Adamit shkrepin shkëndija e vullnetit të epërm, e mendjes së fuqishme hyjnore që vihet përballë racës njerëzore dhe vërshon e derdhet tek ajo.

Por, shikoni me kujdes formën e përgjithshme të mantelit të Perëndisë. Studiues të kohëve të fundit kanë arritur në përfundimin se ka formën e trurit të njeriut. Ngjashmëria është e dukshme, por interpretimi ka lëshuar shumë spekulime të shfrenuara të cilat nuk qëndrojnë në kontekstin e të gjithë afreskut. Disa e interpretojnë se Perëndia është pjellë e trurit të njeriut, një shpikje e imagjinatës njerëzore, por kjo bie ndesh me vetë mjeshttrin i cili besonte dhe i druhej Perëndisë, dhe me vetë veprën e cila është homazh i gjallë jo ndaj papatit por Hyjit. Manteli vërtetë ka formën e trurit të njeriut, dhe kjo nuk bën habi pasi Michelangelo kreu shumë autopsy dhe studime anatomie, por përmes kësaj analogjie pamore midis Hyjit dhe trurit njerëzor, mjeshtri dha mesazhin se ishte mendja hyjnore, imagjinata, aftësia krijuese e Perëndisë autore e njeriut dhe e mbarë krijimit, dhe atë atribut ia dha edhe njeriut, si qenie racionale, me intelekt dhe aftësi krijuese. Dhe mjafton të shohim këtë afresk për të kuptuar sesa e vërtetë është kjo dhoratë e dhënë nga Hyji ndaj njeriut.

Për një çekiç, gjithçka duket si një gozhdë, ndaj mbi çdo imazh mund të zbulojmë forma të tjera në varësi të optikës dhe imagjinatës sonë. Kjo është yshtja e artit.

Ndër më shumë se treqind figurat e afreskut, përveç Adamit, i cili simbolizon origjinën e njeriut, bie në sy një figurë tjetër, ajo e Krishtit, e Gjykatësit të ditës së fundit



të njerëzimit, e cila gjendet në faqen ballore mbi altarin e kapelës.

Afresku ballor pas altarit, i titulluar *Gjykimi i Fundit* i mori pesë vite të tjera Michelangelo. Afresku u pikturua njëzetë e pesë vite më vonë nga afresku i kubesë, gjatë viteve 1536–1541, dhe pasi e përfundoi Michelangelo ishte afërsisht 67 vjeç.

Nëse figura qendrore e afreskut të kubesë ishte Adami, në afreskun ballor figura qendrore është Krishti. Në këtë afresk shpaloset Gjykatësi Hyjnor i shoqëruar nga nëna e tij. Ai duket një njeri me përmasa të fuqishme muskulore, i ri dhe i bukur, me një shprehje dinjiteti të padiskutueshëm. I pushtuar nga retë, ai duket se po ngrihet nga një fron për të ekzekutuar gjykimet e tij. Ai i ngre duart me një lëvizje gjithëpërfshirëse e duket sikur i ndan turmat në të dy anët. Në trup vërehet plaga në anën e tij të djathtë e shkaktuar prej shtizës romake gjatë kryqëzimit. As mimika e as gjesti i tij nuk shfaqin zemërim, por ato duken si një komandë, një urdhër i padiskutueshëm që vë në veprim të gjithë skenën e duket se trazon disa shpirta por edhe paqton besnikët e tij.

Nën krahun e djathtë, shihet nëna e tij Maria, një figurë e rëndësishme në katolicizëm. Ka shumë interpretime mbi qëndrimin dhe shprehinë e saj. Disa

mendojnë se për shkak se ajo e ka të kthyer fytyrën e saj, tregon nënshtrim ndaj autoritetit të djalit të saj. Sidoqoftë, mimika e saj është kaq e butë sa që na tregon se ajo qëndron pranë tij për t'u mbrojtur. Duke parë përbërjen e figurës, shohim se forma tërësore e Krishtit krijon një piramidë, kulmi i së cilës është dora e ngritur e Krishtit, e Gjykatësit të botës, dhe baza e së cilës formon retë ku mbështeten këmbët e tij dhe të Marisë. Kjo i jep stabilitet të duhur figurave që dominojnë të gjithë pamjen e madhe. Piramida është trekëndësh, një figurë gjeometrike e cila simbolizon përsosmërinë, qëndrueshmërinë, pushtetin dhe energjinë, sikurse edhe trininë e shenjtë.

Kjo skenë është ndër krijimet më të ndjera të Michelangelo, e madje edhe më dramatike se e gjithë historia e njerëzimit. Kuptimi i saj moral e poetik i kapërcen kufijtë e historisë së artit dhe përbën një prej bazave të kulturës evropiane të mijëvjeçarit të kaluar e të ri. E gjithë skena shpërthen përpara nesh: në të majtë të Krishtit shpirtit e humbur zbresin për në ferr, ndërsa në të djathtë të tij shpirtat e shpëtuar ngjiten për në parajsë të ndihmuar nga engjëjt; dallohen apostujt dhe besnikët; boritë që bien për të kthyer në jetë të vdekurit; engjëjt dhe djajtë që luftojnë për t'i rrëmbyer njëri-tjetrit shpirtat e njerëzve.



Dhe ja, në tërë këtë skenë kataklizmike, dallojmë autoportretin e vetë Michelangelo. Shikoni figurën poshtë këmbës së majtë të Krishtit: një plak, që gati-gati e prek trupin e Gjykatësit të botës, e që në dorën e tij të majtë mban një lëkurë njeriu të varur, ndërsa tek tjetra një thikë. Ai është Shën Bartolomeo, një prej apostujve të Krishtit i cili u martirizua në Armeni ku u rrop i gjallë. Ajo që mban në dorë është vetë lëkura e tij, por fytyra në të është ajo e Michelangelo.

Përpara syve të mi lëkura ime po tendoset, Teksa mblidhet pas meje dhe formon një nyje,

Dhe unë i tëri lakoheh si një hark pers, shkroi ai.

Mjeshtri la autografin e tij në këtë vepër madhështore. Por siç e shohim aq të mjerë e të trishtuar, ai nuk krekoset me lavdi për mrekullinë e duarve të tij, përkundrazi shpalos autoportretin e vet të frikësuar e të lemerisur, nën një klithmë të padëgjuar por të ndërjetë përmes imazhit, e cila thërret për shpëtim. *Më shpëto, më shpëto*, duket se klith ai, *nuk dua të humbas*. Michelangelo, tashmë i plakur, i druhej gjykimit të madh. Gjatë të gjithë jetës së tij ai kishte patur frikë ndaj Hyjit dhe ajo krupë dukej se ishte shtuar në pleqëri. Autoportreti i tij mbi lëkurën e rrjepur të shenjtorit, tregon aq shumë dhimbje sa që vështirë se mund të largohet nga mendja e shikuesit.

Por, shikoni poshtë e në të majtë të lëkurës së Shën Bartolomeot me fytyrën e Michelangelo. Figura që njihet si "i mallkuari" trazon çdo sy që e shikon. Kjo figurë mund të konsiderohet më tronditëse dhe emocionuese se çdo imazh tjetër. Në të shohim një njeri që ka mbuluar fytyrën me dorën e majtë, dhe sytë dhe shprehia e pjesës së fytyrës që duket shpalos një gjendje emocionale të jashtëzakonshme: atë momentin kur njeriu kupton që po zbrit në ferr. Shprehia e tij nuk tregon vetëm frikë por edhe zhgënjim dhe pendim. Trupi i tij tërhiqet poshtë drejt ferrit nga dy demonë ngjyrë bojë kafe të errët dhe ulliri, si mishra të kalbur që po e tërheqin me forcë drejt vuajtjes së përjetshme. Një gjarpër e ka pickuar atë njeri në kofshën e majtë dhe thonjtë e demonëve i janë ngulur në mish në anën tjetër. Michelangelo e ka pikturuar me aq emocion këtë figurë sa që ne arrijmë të dëgjojmë mendimet e njeriut të mallkuar: *Si? Në ferr? Jo! Jo! Por, unë mendoja se ... Mos, në ferr përjetësisht. Jo. Jo. Jo. Nuk dua të përfundoj atje*. Por në sytë e tij ne arrijmë të ndiejmë pendimin e pandreqshëm: ata sy na tregojnë se ai shpirt kërkon të pendohet por tashmë është vonë. Një njeri që sapo mëson se vendmërritja e tij e përjetshme është ferri dhe jo parajsja, kjo dramë emocionale nuk kishte sesi të përshkruhej më mirë vizualisht sesa nga dora e Michelangelo.

Gjatë jetës së tij Michelangelo njihet në Firence, Romë, në mbarë Italinë, e më gjerë, si një ndër artistët më të mëdhenj të kohës. Por pavarësisht suksesit që kishte arritur dhe fitimeve të mëdha, edhe pse ai mbështeste financiarisht babanë dhe katër vëllezërit e tij, ata nuk e vlerësuan kurrë për profesionin që ai kishte zgjedhur. Me të mbaruar afreskun e kubesë së *Kapelës Sistine*, Michelangelo i shkroi një letër babait dhe vëllezërve të tij, ku ndër të tjera thuhet: "E gjithë kjo që kam bërë e kam bërë për t'ju ndihmuar. Por ju kurrë nuk e keni ditur ose nuk keni dashur ta besoni, ndaj, Perëndia ju ndihmohtë."

Betejat e tij personale, sfidat e brendshme të thirrjes së artit, gjenialiteti i cekur nga natyra e tij melankolike, dhimbjet fizike sakrifkuese për punën që duhet të kryente ishin të rënda për supet e mjeshtrit, por Michelangelo e dinte se ajo ishte vetëm një barrë e vogël në krahasim me ndikimet që do kishin veprat e tij në mijëvjeçarët e ardhshëm, dhe sesi njeriu do niste ta shihte veten, njerëzimin, mbarë universin dhe Hyjin me një optikë e mendim tërësisht ndryshe, vetëm për shkak të nënshtrimit që mjeshtri tregoi ndaj artit.

PANAIRI I 22^{të} I LIBRIT

7-12 QERSHOR / JUNE
PALLATI I RINISË

PRISHTINA

BOOK FAIR



SHOQATA
E BOTUESVE
TË KOSOVËS
www.panairilibr.it



PALLATI I RINISË
KULTURËS DHE SPORTEVE